# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5489
E mërkurë, 30 maj 2018
çmimi 0.40 €


## Thaçi: Do ta kemi mbështetjen e Austrisë për Interpol

FAQE 2



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë vizitës zyrtare në Austri, të martën ka zhvilluar një takim me kancelarin austriak Sebastian Kurz. Pas takimit, Thaçi ka thënë se Kosova e ka mbështetjen e Austrisë për liberalizmin e vizave, Interpolin dhe dialogun me Serbinë


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM VELIU FAQE 4-5



# Opozita duhet të marrë përgjegjësi në dialogun me Serbinë

### - Jemi parti institucionaliste dhe nuk lidhemi me emra se kush do ta udhëheqë dialogun

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka thënë se në fazën finale të dialogut me Serbinë secili institucion duhet të marrë pjesë në këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Veliu ka theksuar se, përveç institucioneve shtetërore, një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces duhet ta ketë edhe opozita. Ai ka thënë se LDK-ja si parti institucionaliste nuk lidhet shumë me emra se kush do ta udhëheqë dialogun me Serbinë. Veliu ka mohuar mundësinë që brenda LDK-së të ketë ndarje të mëdha rreth asaj nëse duhet që presidenti Hashim Thaçi ta udhëheqë këtë proces. Sipas tij, qëndrimi zyrtar i LDK-së për këtë çështje do të përkrahet nga çdo zyrtar i saj

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS

# Ministrat do të japin llogari për vizitat jashtë vendit



Ministrat e Qeverisë së Kosovës tash e tutje do të japin llogari për secilën vizitë të realizuar jashtë vendit. Ky vendim është marrë të martën në mbledhjen e kabinetit qeveritar. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se çështja e vizitave jashtë vendit do të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjet e Qeverisë. Ai ka thënë se ministrat do ta informojnë atë për qëllimin e vizitës, kohëzgjatjen e saj si dhe numrin e pjesëmarrësve në atë vizitë FAQE 3



## Lufta kundër krimit dhe korrupsionit, sfida kryesore e Kosovës

Përfaqësuesit e bordit të përbashkët koordinues për sundimin e ligjit kanë bërë me dije se edhe më tutje për Kosovën sfidë kryesore mbetet luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Megjithatë, ata kanë vlerësuar se Kosova ka bërë përparim në shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit FAQE 7

## AKTUALE



YLBER ÇITAKU


HASHIM THAÇI KRYENEGOCIATOR! F. 11

KDI-ja: KUVENDI TË THËRRASË SEANCË PËR DIALOGUN ME SERBINË F. 6

VESELI: SË SHPEJTI DO TË NDODHË LIBERALIZIMI I VIZAVE F. 6


## EKONOMI


QEVERIA MIRATON STATUTIN PËR 'TREPÇËN' F. 9

MOSTRANSPARENCA NË PROKURIMIN PUBLIK RRIT DYSHIMET PËR KORRUPSION F. 9


## KULTURË


FERIZAJ BËHET GATI PËR 'DITËT E KULTURËS' F. 13


## SPORT


GASHI: VËLLAZNIMI ISHTE I PAFAT F. 14

TITULLI NË KONKURRENCËN E FEMRAVE VENDOSET TË ENJTEN F. 14



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## DASH: Liritë fetare në Kosovë me shumë probleme




UASHINGTON, 29 MAJ - Departamenti Amerikan i Shtetit ka thënë se Kosova ka bërë përpjekje që të ketë ligje të mira sa iu përket të drejtave fetare mirëpo në shumë raste këto të drejta u janë mohuar besimtarëve të religioneve të ndryshme në Kosovë.
Në raportin për vitin 2017 të DASh-it për tolerancën fetare në botë flitet edhe për mbështetjen financiare që Qeveria e Kosovës iu bënë institucionit të edukimit islam, BIK, Medresesë në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan.
Megjithatë, për këtë fakt në raport thuhet se janë ankuar grupe të tjera religjioze të cilat nuk marrin mbështetje financiare. "Disa pjesëtarë të grupeve të tjera dhe përfaqësues të tjerë jofetarë kanë thënë se ata ishin të shqetësuar se Qeveria nuk e kishte financuar edukimin religjioz për grupet e tjera fetare", thuhet në raport.
Më tej, thuhet se Qeveria ka punuar së bashku me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Shoqërinë Civile në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Si pjesë e strategjisë së Qeverisë, BIK-u thuhet se ka mbajtur sesione në Medrese dhe Fakultetin e Studimeve Islame me qëllim të njoftimit të të rinjve që të mos bien pre e ekstremizmit.
Në raport përmendet edhe raportimi i medieve për presionin që Qeveria turke ua kishte bërë institucioneve të Kosovës për t'i mbyllur shkollat e lidhura me klerikun mysliman, Fethullah Gylen.
Raporti përmend Lëvizjen Vetëvendosje për incidentin në Gjakovë kur "protestuesit hodhën gurë dhe ngjyrë të kuqe në autobusin ku gjendeshin pelegrinët duke dëmtuar dritaret dhe duke shkruar me sprej në murin e jashtëm të kishës fjalën 'vrasës'. Policia shpërndau protestuesit dhe arrestoi shtatë nga ata për mosbindje ndaj urdhrave të policisë dhe vandalizëm", thuhet në raport.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të martën është takuar me kancelarin e Austrisë, Sebastian Kurz

# Thaçi: Do ta kemi mbështetjen e Austrisë për Interpol

**Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë vizitës zyrtare në Austri, të martën ka zhvilluar një takim me kancelarin austriak Sebastian Kurz. Pas takimit, Thaçi ka thënë se Kosova e ka mbështetjen e Austrisë për liberalizmin e vizave, Interpolin dhe dialogun me Serbinë**



PRISHTINË , 29 MAJ - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, së bashku me zëvendëskryeministrin e parë, Behgjet Pacollin, janë pritur në Bundeskanlzeramt nga kancelari austriak Sebastian Kurz. Në këtë takim është biseduar me kancelarin e Austrisë për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në rrafshin politik, ekonomik, arsimor dhe kulturor. "Kemi marrëdhënie të shkëlqyera me Austrinë në të gjitha fushat. Austria është ndër investitoret kryesor në Kosovë", ka thënë presidenti.
Presidenti Thaçi ka kërkuar mbështetje nga kancelari austriak për dinamizimin e perspektivës evropiane të Kosovës, meqë Austria do ta marrë presidencën e radhës së Bashkimit Evropian. "Kosova është e përkushtuar për paqe të qëndrueshme, zhvillim dhe sundim të ligjit. Viti 2018 është vit i mundësive për të ardhmen evropiane të Kosovës dhe tërë Ballkanit Perëndimor", ka theksuar presidenti Thaçi. Ai ka thënë se e mirëpresim kryesimin e radhës të BE-së nga Austria dhe presim të vazhdohet me praktikën e samitit në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.
Në këtë takim është biseduar edhe për fazën e fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, proces ky i lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur nga shtetet mike të Kosovës. "Kosova është e gatshme për fazën përfundimtare të dialogut. Jemi duke ndërtuar konsensusin politik dhe shoqëror për dialogun", tha Thaçi.
Kancelari austriak Sebastian Kurz ka theksuar se Austria është mike e rajonit, veçanërisht e Kosovës, derisa ka mirëpritur kryesimin e radhës të BE-së nga Austria dhe përkrahjen për Ballkanin Perëndimor në BE. "Ju përkrahim në liberalizimin e vizave. Të avancojmë bashkëpunimin ekonomik", ka thënë kancelari Kurz.
Ndërkohë pas takimit me kancelarin austriak, presidenti Thaçi ka thënë se Kosova e ka mbështetjen e Austrisë për liberalizmin e vizave, Interpolin dhe dialogun me Serbinë. "Diskutuam për mbështetjen që Austria do t'i japë Kosovës në Interpol, por edhe mbështetjen edhe më të fuqishme për liberalizimin e vizave. Do të ndodhë kjo mbështetje pasi Kosova ka përmbushur 95 kriteret e kërkuar nga Komisioni Evropian. Edhe dialogu që është menduar të fillojë në fund të qershorit apo në fillim korrikut do ta ketë mbështetjen nga Austria pasi ky vend e merr kryesimin e BE-së", ka thënë presidenti Thaçi.
Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili po qëndron në Austri, ka takuar edhe ish-presidentin e Austrisë, Heinz Fischer, të cilin e ka falënderuar për kontributin e dhënë për Kosovën. Këtë e ka bërë me dije vetë Thaçi përmes një postimi në "Facebook": "Një takim të përzemërt e patëm edhe me ish-presidentin austriak Heinz Fischer, i cili që nga viti 2004 ka mbështetur rrugëtimin e Kosovës drejt pavarësisë dhe shtetndërtimit. Ish-presidentin Fischer e falënderova për kontributin që ka dhënë për Kosovën, rajonin dhe tërë Evropën", ka shkruar Thaçi.

## Rama: Nuk jap dorëheqje prej protestave




TIRANË, 29 MAJ - Kryeministri Edi Rama në një intervistë për televizionin francez "France 24" e quajti protestën e opozitës si një çështje e brendshme e vendit dhe që nuk duhet t'i zërë faqet e para të medieve ndërkombëtare.
Ai shprehet se nuk ka pse jep dorëheqje.
"Mendoj se nuk është një lajm që duhet t'i zërë faqet e para të gazetave ndërkombëtare, është jeta e brendshme e vendit, opozita është duke protestuar dhe ka një qeveri që është në fuqi. Ta kërkosh dorëheqjen e kryeministrit në Shqipëri kjo ndodh shpeshherë, që kur kemi hyrë në demokraci. Po dhe në fakt kur flas në një gjuhë të huaj, nuk flas ndonjëherë për opozitën se mendoj se është çështje e brendshme e Shqipërisë. Shqipëria ka parë manifestime më të mëdha. Kjo është jeta demokratike e vendit", është shprehur kryeministri Rama. Ai tha se Shqipëria nuk është duke trokitur në dyert e BE-së për t'u bërë anëtar, por po përgatitet për hapjen e negociatave. "Nuk jemi duke trokitur në dyer të BE-së për t'u bërë anëtar, po jemi duke u përgatitur për hapjen e negociatave që do të vazhdojnë shumë vite për të vendosur në jetë të gjitha reformat e nevojshme për të përmirësuar gjithçka që mund të bëjmë dhe nga pikëpamja e ligjvënies", tha Rama.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Ministrat do të japin llogari për vizitat jashtë vendit

Ministrat e Qeverisë së Kosovës tash e tutje do të japin llogari për secilën vizitë të realizuar jashtë vendit. Ky vendim është marrë të martën në mbledhjen e kabinetit qeveritar. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se çështja e vizitave jashtë vendit do të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjet e Qeverisë. Ai ka thënë se ministrat do ta informojnë atë për qëllimin e vizitës, kohëzgjatjen e saj si dhe numrin e pjesëmarrësve në atë vizitë

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 MAJ - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka miratuar urdhrin për stafin qeveritar dhe shërbimin civil për zbatimin e udhëzimit administrativ për udhëtimet zyrtare. Ky udhëzim ka për qëllim rregullimin e mënyrës së realizimit të udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve për këto udhëtime, duke siguruar përdorimin ekonomik dhe efikas të mjeteve financiare të Qeverisë së Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se, sipas urdhrit të aprovuar, ministrat janë të obliguar që paraprakisht ta informojnë kryeministrin për secilin udhëtim zyrtar dhe më pas të raportojnë për qëllimin dhe pjesëmarrësit në udhëtim. Ai ka thënë se ministrat obligohen që çdo tre muaj të raportojnë për udhëtimet e stafit të ministrive të tyre dhe në të ardhmen do të ketë një pikë të rregullt të rendit të ditës në mbledhjet e Qeverisë, në të cilën ministrat do të raportojnë për udhëtimet zyrtare të zhvilluara nga ministria e tyre. "Nuk kam për të harruar që në çdo mbledhje kam për t'ju pyetur se ku keni qenë? Sa keni ndjetë? Dhe kë e keni pas me vete? Ky rregull do të vendoset tash e tutje. Çdo kush që do të udhëtojë duhet të raportojë paraprakisht", është shprehur Haradinaj.

Po në mbledhjen e së martës Qeveria e Kosovës ka emëruar Mendim Rugovën koordinator për Ndryshime Klimatike dhe Çështje të Ambientit dhe Rexhep Hotin koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Republikën e Kosovës.

Kabineti qeveritar ka aprovuar edhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme". Me miratimin e këtij projektligji dhe me aprovimin e tij në Kuvendin e Kosovës do të hapet rruga që Kosova dhe bizneset në Kosovë të përfitojnë nga ky program zhvillimor i Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Qeveria pjesërisht ka anuluar, ndryshuar dhe plotësuar vendimin përfundimtar për shpronësimet e pronave për interes publik të pronave që preken nga ndërtimi i rrugës nacionale Prishtinë - Mitrovicë. Mbështetjen e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe vendimi preliminar për shpronësimet për interes publik për pronat të cilat preken nga shndërrimi në "Shtëpi Muze" i shtëpisë së Ukshin Hotit në Krushë të Madhe të Komunës së Rahovecit.

Me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e fushës së sportit "Stadiumi Sintetik" në Zabelin e Ulët të Komunës së Drenasit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për shqyrtimin e mëtejmë për shpronësimin për interes publik të pronave të ish-Radio Televizionit të Prishtinës në këtë zonë kadastrale.

Qeveria ka miratuar edhe vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Republikën e Kosovës, në pronat e Agjencisë Pyjore të Kosovës në Harilaq të Komunës së Fushë-Kosovës. Objekti për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme do ta mundësojë menaxhimin e mbeturinave në mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt nga aspekti i mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

## Qeveria ndan 300 mijë euro për pushimet verore të veteranëve të UÇK-së

Gjithashtu, në mbledhjen e së martës Qeveria ka aprovuar kërkesën e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së për ndarjen e 300 mijë eurove për rehabilitimin e 1 500 pjesëtarëve të kësaj organizate. Këto mjete është paraparë të shfrytëzohen për pushimet e veteranëve të UÇK-së në bregdetin shqiptar.

## Qeveria merr vendim për mbështetje financiare të qindra specializantëve

Kabineti qeveritar ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e specializantëve me vetëfinancim. Arsyeja pse është marrë ky vendim ka të bëjë me situatën aktuale në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ku, sipas analizave, numri i kuadrove profesioniste shëndetësore është në nivel të ulët në krahasim me vendet e rajonit dhe vendet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik.



## Haradinaj kërkon të ketë stabilitet energjetik në vend

PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të martën se Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm i cili duhet të shfrytëzohet në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe stabilitetit energjetik në vend.

Haradinaj në takim pune me Bordin e KEK-ut, menaxhmentin dhe anëtarët e tjerë të Komisionit Teknik të Qeverisë, në të cilën u diskutua për drejtimin që do të marrë zhvillimi i "Mihjes së Re" dhe për hapat që duhen ndërmarrë, ka thënë se janë në kohën kur duhet të ndërmerren veprime të sakta dhe në kohë sa iu përket obligimeve të cilat ndërlidhen me investimet për "Kosovën e Re". Ai ka thënë se në këtë drejtim një prej punëve kryesore është edhe Miniera e Re.

Në mënyrë që të mos ndodhin vonesa, kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga të pranishmit që si profesionistë të fushës dhe në bazë të kompetencave të tyre ta ndihmojnë Qeverinë e vendit me veprimet e tyre që punët rreth minierës të përfundojnë me kohë, e përmes kësaj të ndihmohet vendi dhe jetësimi i projektit të ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re".

Flet për "Epokën e re", Agim Veliu

# Opozita duhet të marrë përgjegjësi në dialogun me Serbinë

## - Jemi parti institucionaliste dhe nuk lidhemi me emra se kush do ta udhëheqë dialogun



Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka thënë se në fazën finale të dialogut me Serbinë secili institucion duhet të marrë pjesë në këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Veliu ka theksuar se, përveç institucioneve shtetërore, një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces duhet ta ketë edhe opozita. Ai ka thënë se LDK-ja si parti institucionaliste nuk lidhet shumë me emra se kush do ta udhëheqë dialogun me Serbinë. Veliu ka mohuar mundësinë që brenda LDK-së të ketë ndarje të mëdha rreth asaj nëse duhet që presidenti Hashim Thaçi ta udhëheqë këtë proces. Sipas tij, qëndrimi zyrtar i LDK-së për këtë çështje do të përkrahet nga çdo zyrtar i saj

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 29 maj** - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka bërë me dije se në fazën finale të dialogut me Serbinë duhet t'i marrë përgjegjësitë që i takojnë edhe opozitës. Ai ka thënë se ky është një proces madhor, i cili nuk i takon vetëm një subjekti politik.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Veliu ka deklaruar se, përveç institucioneve kushtetuese, një rol të jashtëzakonshëm duhet ta kenë të gjitha subjektet opozitare. "Kjo është një prej çështjeve madhore që e kemi diskutuar në tryezë bashkërisht. Siç po duket, kjo faza e fundit e dialogut final do të jetë një proces jo i lehtë për Kosovën. Ne si LDK edhe në këtë aspekt kemi qenë të hapur të diskutojmë në mënyrë që përgjegjësinë ta marrin edhe institucionet kushtetuese në bazë të përgjegjësive që kanë, por një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces ta luajë edhe gjithë opozita", ka thënë Veliu. Ai ka deklaruar se LDK-së nuk i intereson shumë se kush do ta udhëheqë këtë proces. "Duke pasur parasysh se LDK-ja është parti institucionaliste, ne nuk lidhemi shumë me emra dhe nuk bisedojmë shumë për emra. Ne mendojmë që secili institucion në Kosovë duhet ta luajë rolin e vet dhe duhet ta marrë përgjegjësinë që i takon në bazë të ligjeve dhe kushtetutës", ka thënë Veliu.

Nënkryetari i LDK-së ka folur edhe për tryezat e subjekteve politike të organizuara deri më tani. Sipas Veliut, qëllimi i LDK-së me këto tryeza ka qenë që të gjendet një konsensus nacional për tema të mëdha dhe të caktohet data e zgjedhjeve të parakohshme. "Ne si LDK i kemi ofruar koalicionit qeverisës mbështetje në këto çështje që janë madhore për Kosovën, por ne nuk kemi gatishmëri t'i bëjmë argat ditor Qeverisë. Pra, gatishmëria jonë ka qenë t'i ofrojmë mundësi Qeverisë t'i kryejmë temat e mëdha dhe ta dimë datën e zgjedhjeve të reja, sepse vetëm me zgjedhje të reja mund të legjitimohet një qeverisje tjetër e Kosovës", është shprehur Veliu, duke paralajmëruar se nëse nuk do të arrihet konsensus, LDK-ja do ta ngrehë mocion mosbesimi ndaj Qeverisë. "Nuk është çështja e guximit këtu. Është çështje e asaj që ju thashë më herët, se ne ende nuk kemi ndryshuar qëndrim si LDK. Ne ende i japim përparësi mundësisë së gjetjes së një konsensusi kombëtar. Mirëpo, në momentin që vlerësojmë se nuk ka gatishmëri për konsensus, atëherë ne sigurisht se do ta ndërmarrim hapin tjetër", ka thënë Veliu.

**"Epoka e re":** *Z. Veliu, deri më tani janë mbajtur tri tryeza të partive politike në të cilat është diskutuar mundësia e gjetjes së një konsensusi politik për temat e mëdha. Cila është përshtypja juaj nga këto tryeza, meqenëse keni marrë pjesë në to?*

**Veliu:** LDK-ja ka iniciuar organizimin e tryezave të partive politike parlamentare dhe joparlamentare, me qëllim që vendin ta nxjerrim nga kriza institucionale dhe politike. Vlerësimi ka qenë se vendi është në një krizë të thellë institucionale dhe politike. Me anë të këtyre tryezave kemi synuar t'i ofrojmë mundësi koalicionit qeverisës dhe qytetarëve të Kosovës, që ta funksionalizojmë qeverisjen për disa çështje të cilat si LDK i kemi vlerësuar se janë të rëndësisë nacionale. Deri më tani janë mbajtur tri tryeza. E para është mbajtur nga LDK-ja, e dyta nga PDK-ja, e treta nga LV-ja. Deri këtu përshtypjet për këto tryeza janë pozitive, sepse kemi diskutuar hapur për çështjet që janë me interes për Kosovën.

**"Epoka e re":** *Në bazë të asaj që është thënë në këto tryeza, besoni se mund të arrihet ndonjë konsensus kombëtar për çështjet që janë diskutuar?*

**Veliu:** Ne kemi besuar se mund ta arrijmë një konsensus të përbashkët për temat e karakterit kombëtar. Ne si LDK këto çështje i kemi biseduar edhe në kryesi të partisë, pastaj kemi dashur t'i japim përparësi një konsensusi të subjekteve politike, duke përfshirë koalicionin qeverisës, në mënyrë që ta nxjerrim vendin nga kriza, por me qëllim që ta caktojmë edhe datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Si LDK i kemi ofruar koalicionit qeverisës mbështetje në çështjet madhore për Kosovën, por nuk kemi gatishmëri t'i bëjmë argat ditor Qeverisë. Pra, gatishmëria jonë ka qenë t'i ofrojmë mundësi Qeverisë t'i kryejmë temat e mëdha dhe ta dimë datën e zgjedhjeve të reja, sepse vetëm me zgjedhje të reja mund të legjitimohet një qeverisje tjetër e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Partnerët e koalicionit qeverisës e kanë kundërshtuar mbajtjen e zgjedhjeve të reja të cilat po i kërkon opozita. Me këto qëndrime të kundërta sa mund të shkohet drejt ndonjë konsensus kombëtar për temat e tjera?*

**Veliu:** Deri më tani kemi dallim vetëm sa iu përket zgjedhjeve të reja. Mirëpo, me një vullnet të të gjitha subjekteve politike, unë mendoj se duhet të gjendet një kompromis që të bëhet një zgjidhje e kësaj nyje. Përndryshe, nëse nuk arrijmë një pajtim, ne mund të shkojmë tutje me hapa të tjerë.

**"Epoka e re":** *Që i bie se do të ngrini mocion mosbesimi ndaj Qeverisë?*

**Veliu:** Po, sigurisht. Atëherë ne do të bisedojmë me të gjitha subjektet politike në mënyrë që t'i bëjmë votat e nevojshme për rrëzimin e Qeverisë.



**"Epoka e re":** *Në opinion po shihet sikur opozita nuk po ka guxim të iniciojë mocion mosbesimi ndaj Qeverisë ngaqë nuk i ka numrat e mjaftueshëm?*
**Veliu:** Nuk është çështja e guximit këtu. Është çështje e asaj që ju thashë më herët se ne ende nuk kemi ndryshuar qëndrim si LDK. Ne ende i japim përparësi mundësisë së gjetjes së një konsensusi kombëtar. Mirëpo, në momentin që vlerësojmë se nuk ka gatishmëri për konsensus, atëherë sigurisht se do ta ndërmarrim hapin tjetër.

**"Epoka e re":** *Një çështje që është diskutuar në këto tryeza ka qenë edhe ajo e fazës finale të dialogut me Serbinë. Cili është qëndrim i LDK-së rreth kësaj çështje?*
**Veliu:** Kjo është një prej çështjeve madhore që e kemi diskutuar në tryezë bashkërisht. Siç po duket, kjo faza e fundit e dialogut final do të jetë një proces jo i lehtë për Kosovën. Ne si LDK edhe në këtë aspekt kemi qenë të hapur të diskutojmë në mënyrë që përgjegjësinë ta marrin edhe institucionet kushtetuese në bazë të përgjegjësive që kanë, por një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces ta luajë edhe gjithë opozita.

**"Epoka e re":** *Pra, LDK-ja është e gatshme t'i marrë përgjegjësit që i takojnë në procesin e dialogut me Serbinë?*
**Veliu:** Duke mos i ditur ende të gjitha detajet rreth këtij procesi, ne ende në kryesi nuk e kemi diskutuar dhe nuk kemi qëndrim definitiv sa i takon kësaj çështje.

**"Epoka e re":** *Platforma e Qeverisë për këtë fazë të dialogut, e cila shumë shpejt do të diskutohet në Kuvend, parasheh që udhëheqës i këtij procesi të jetë presidenti Hashim Thaçi. E përkrah LDK-ja këtë propozim?*
**Veliu:** Duke pasur parasysh se LDK-ja është parti institucionaliste, ne nuk lidhemi shumë me emra dhe nuk bisedojmë shumë për emra. Ne mendojmë se secili institucion në Kosovë duhet ta luajë rolin e vet dhe duhet ta marrë përgjegjësinë që i takon në bazë të ligjeve dhe kushtetutës.

# Kosova përkrah përpjekjet e Maqedonisë për zgjidhjen e kontestit të emrit

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka qëndruar të martën për vizitë në Kosovë. Ai është pritur në takime të ndara nga presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Në këto takime Ahmeti ka marrë përkrahje nga liderët shtetërorë për zgjidhjen e kontestit rreth emrit të Maqedonisë

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**



PRISHTINË, 29 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka pritur në takim kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe për rëndësinë e integrimit euroatlantik të dy vendeve. "Është shumë e rëndësishme të ecim përpara si rajon, sepse vetëm kështu e forcojmë paqen dhe stabilitetin në tërë Ballkanin Perëndimor", ka thënë Thaçi, duke shtuar se Kosova i përkrah përpjekjet për zgjidhjen e kontestit rreth emrit të Maqedonisë. "Zgjidhja e kontestit të emrit, rrjedhimisht hyrja e Maqedonisë në NATO, është në interes të paqes në tërë rajonin tonë", ka theksuar ai.
Thaçi dhe Ahmeti kanë folur edhe për rëndësinë e autoudhës Prishtinë - Shkup, e cila do t'i afrojë edhe më shumë qytetarët me njëri - tjetrin. Me këtë rast, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ka vlerësuar se bashkëpunimi i afërt i lidershipit shqiptar ka bërë që të përmirësohet edhe pozicioni i shqiptarëve në Maqedoni.
Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli të martën ka pritur në takim kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në Maqedoni, Ali Ahmeti. Në këtë takim Veseli e Ahmeti kanë diskutuar për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe në Maqedoni, si dhe për mënyrat e thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Të dy bashkëbiseduesit kanë vlerësuar lart raportet ndërfqinjësore dhe kanë theksuar nevojën e kultivimit të mëtejmë të tyre e të bashkëpunimit me interes reciprok si në fushën e ekonomisë, po ashtu edhe të arsimit e të kulturës.
Veseli e Ahmeti kanë konstatuar se Kosova dhe Maqedonia, si dy faktorë të rëndësishëm paqeje dhe stabiliteti në rajon, tashmë kanë hyrë në rrugën e pandalshme të integrimit euroatlantik, si perspektivë e vetme për të ardhmen e të dyja vendeve. Veseli ka vlerësuar rolin e faktorit shqiptar në Maqedoni si për ruajtjen e stabilitetit të brendshëm, po ashtu edhe për orientimin euroatlantik të Maqedonisë.
Kurse lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ka vlerësuar lart hapat që ka bërë Kosova për konsolidimin e institucioneve shtetërore dhe për rritjen e përfaqësimit e të njohjes ndërkombëtare të saj. Po ashtu, kryetari i BDI-së është pritur në takim edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj. Me këtë rast Haradinaj ka vlerësuar rolin konstruktiv të kryetarit Ahmeti dhe të shqiptarëve në Maqedoni, për të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, Maqedonia dhe rajoni.
Kryeministri e ka njoftuar Ahmetin për progresin që ka arritur Kosova dhe hapat që është duke ndërmarrë Qeveria në proceset integruese evropiane dhe euroatlantike si dhe për zhvillimin ekonomik të vendit dhe hapjen e perspektivës për të rinjtë. "U pajtuam të angazhohemi bashkërisht që t'i gjejmë zgjidhje shumë çështjeve të rëndësishme të cilat presin prej kohësh", ka deklaruar Haradinaj.



# Veseli: Së shpejti do të ndodhë liberalizimi i vizave

**Prishtinë, 29 maj (ER)** - Në përvjetorin e nëntë të Kuvendit të të Rinjve të Kosovës, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se ky Kuvend është shembulli më i mirë i organizatave rinore në Kosovë. Kreu i Kuvendit ka thënë se duhet të punohet edhe më shumë në mënyrë që të krijohet perspektivë për të gjithë. Ai ka thënë se me resurset e jashtëzakonshme natyrore që vendi ka, duke përfshirë edhe rininë, zhvillimi është i garantuar.

Duke folur për liberalizimin e vizave, kryeparlamentari Veseli ka thënë se kjo nuk do të thotë largim nga vendi ynë, por përkundrazi, perspektivë në vendin tonë për ta shtyrë atë drejt zhvillimit. "Së shpejti do të ndodhë liberalizimi i vizave por të rinjtë tanë nuk duhet asnjë moment ta shohin këtë si mundësi për largim nga Kosova. Liberalizimi do të thotë sjellje të Evropës në Kosovë. Kosova ka nevojë për të rinjtë e saj. Nuk ka zhvillim pa aktivizimin e potencialit të të rinjve. Rinia është Dekada e re e Pavarësisë së Kosovës. Shteti i Kosovës nuk do të qëndrojë indiferent ndaj ëndrrave të rinisë. Shteti i Kosovës është dhe do të mbetet në shërbim të vizionit të rinisë", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Veseli ka shtuar se kjo dekadë do ta përcaktojë ndryshimin e kombit tonë. "Mos shiko majtas dhe djathtas, nuk është askush. Shikojeni njëri-tjetrin dhe jeni bashkë, sepse ju jeni e ardhmja e Kosovës. Ju duhet t'i merrni përgjegjësit e juaja. Kosova është e jona dhe më së shumti e atyre që janë me shumicë. Shumica është rinia e Kosovës", është shprehur Veseli.



# KDI-ja: Kuvendi të thërrasë seancë për dialogun me Serbinë

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 29 maj** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme për çështjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo kërkesë e KDI-së ka ardhur pasi Qeveria e Kosovës më 19 prill të këtij viti ka miratuar projektplatformën për finalizimin e dialogut Kosovë - Serbi, e cila i është dorëzuar presidentit të Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës. "Kjo platformë në formën e një draft-rezolute u shqyrtua në Komisionin për Punë të Jashtme më 4 maj 2018. Ky komision vendosi që platformën ta procedojë në seancë plenare, megjithatë Kuvendi deri tani është i painteresuar për t'i dhënë prioritet dialogut Kosovë - Serbi. Duke e konsideruar rëndësinë e procesit të dialogut që ndërlidhet drejtpërdrejt me procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE, konsolidimin e brendshëm dhe ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe normalizimin e marrëdhënieve në mes dy shteteve, KDI-ja vlerëson se Kuvendi i Kosovës duhet të jetë epiqendra e diskutimeve për hapat e mëtejmë rreth këtij procesi. KDI-ja kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që sa më parë të thërrasin një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar lidhur me fazën e re të dialogut me Serbinë dhe platformën shtetërore të Kosovës për këtë proces", është thënë në njoftimin e KDI-së.



Sipas këtij njoftimi, debati rreth së ardhmes së këtij procesi duhet të zhvillohet në Kuvendin e Kosovës, ku partitë parlamentare duhet të synojnë të ndërtojnë konsensus politik dhe të artikulojnë qartazi qëndrimet e shtetit të Kosovës në këto bisedime. "Deputetët e Kuvendit të Kosovës në këtë platformë duhet t'i përcaktojnë temat e diskutimit, pritshmërinë e palës së Kosovës, rolin e institucioneve dhe ekipin negociues, duke i dhënë legjitimitet këtij procesi shtetëror me miratimin e një rezolute e cila do të garantojë bashkërendim të institucioneve, gjithëpërfshirje, llogaridhënie dhe transparencë", është thënë njoftimin e KDI-së.

KDI-ja u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të jenë më aktivë për trajtimin e çështjeve të dialogut në seancat e Kuvendit dhe në mbledhjet e komisioneve.

# Jahjaga: Institucionet dështuan në parandalimin e dhunës në familje

**Prishtinë, 29 maj** - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë se institucionet e Kosovës kanë dështuar në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Në konferencën e cila është organizuar të martën me temë "Drejtësi për gratë e vrara në aktet e dhunës në familje" në kuadër të Festivalit "FemArt", Jahjaga ka thënë se është e zhgënjyer me mosveprimin e institucioneve kompetente në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie. "Ndihem e zhgënjyer me institucionet përgjegjëse që nuk arrijnë t'i dënojnë dhe t'i sjellin para drejtësisë me kohë kryesit e këtyre veprave. Ndihem e pikëlluar për ata që humbin jetën si pasojë e dhunës së ushtruar ndaj tyre vetëm se janë gra", ka thënë ish-presidentja Jahjaga.



Është mbajtur takimi i bordit të përbashkët koordinues për sundimin e ligjit

# Lufta kundër krimit dhe korrupsionit, sfida kryesore e Kosovës

Përfaqësuesit e bordit të përbashkët koordinues për sundimin e ligjit kanë bërë me dije se edhe më tutje për Kosovën sfidë kryesore mbetet luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Megjithatë, ata kanë vlerësuar se Kosova ka bërë përparim në shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 29 maj - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE), Nataliya Apostolova, të martën në takimin e bordit të përbashkët koordinues për sundimin e ligjit, ka thënë se Kosova ka bërë përparim në shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit por, sipas saj, sfidë mbetet lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Apostolova ka përgëzuar institucionet e Kosovës për përpjekjet që kanë bërë për zbatimin e prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme të parapara në Agjendën Evropiane të Reformave në kuadër të komponentit "Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit". "Ajo që mbetet për t'u bërë në fushën legjislative është miratimi i shpejtë i dispozitave në lidhje me pezullimin dhe heqjen e zyrtarëve publikë, përkatësisht të paditur dhe të dënuar për korrupsion. Dispozitat ligjore të nevojshme për ata që janë dënuar, janë futur në Kodin e ri Penal, i cili tani është para Kuvendit të Kosovës. Kam mësuar se dispozitat përkatëse ligjore për pezullimin e zyrtarëve publikë nën hetim do të futen në Kodin e ri të Procedurës Penale, i cili aktualisht është duke u rihartuar. Ne mezi presim ta shohim miratimin me shpejtësi të të dy kodeve nga Kuvendi i Kosovës", ka deklaruar Apostolova.

Ndërsa shefja e EULEX-it, Aleksandra Papadopoulou, është përqendruar në procesin e integrimit të drejtësisë në veriun e Kosovës, duke thënë se Gjykata Themelore e Mitrovicës kërkon forcim të mëtejshëm. "Kjo bëhet nëpërmjet masave që synojnë tejkalimin e barrierave gjuhësore ndërmjet stafit gjyqësor serb dhe shqiptar si dhe përmes planeve të veprimit për ta trajtuar ngarkesën e madhe të rasteve me të cilat përballet gjykata e formuar rishtazi", ka theksuar ajo.

Papadopoulou ka lavdëruar Kosovën për përparimin e bërë në zbatimin e udhërrëfyesve të bordit të përbashkët koordinues për sundimin e ligjit për ta siguruar qëndrueshmërinë lokale, veçanërisht në kohën kritike kur EULEX-i është duke u larguar gradualisht nga disa fusha kyçe të sundimit të ligjit. Kurse ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka shpjeguar masat e ndërmarra për forcimin e kornizës legjislative që synon parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Korrupsioni është një fenomen që është vështirë të adresohet dhe në të njëjtën kohë problem që nuk mund t'ia lejojmë vetes ta injorojmë. Është me rëndësi të madhe ta luftojmë atë për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të krijuar një rrugë solide drejt ndërtimit të së ardhmes sonë evropiane", ka theksuar Tahiri, duke shtuar se pezullimet dhe largimet e zyrtarëve publikë që akuzohen ose janë dënuar për korrupsion adresohen përmes Projektkodit të ri Penal dhe do të përpunohen më tej përmes Projektkodit të Procedurës Penale. Ndërkohë kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, ka thënë se Kosova ka arritur progres në disa fusha të politikave por, sipas tij, ka nevojë për t'i avancuar më tej këto reforma të rëndësishme. Idrizi ka shprehur përkushtimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për t'i përmbushur detyrimet e mbetura. Edhe kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, ka folur për progresin e arritur kohët e fundit nga sistemi prokurorial në Kosovë, me theks të veçantë në aktivitetet e planifikuara për përmirësimin e mëtejshëm të administratës nëpërmjet legjislacionit sekondar, projektstrategjive dhe politikave përkatëse.



## Hoti drejton kritika për diplomacinë e Kosovës



Prishtinë, 29 maj (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të hënën se politika e jashtme e vendit tonë ka kaluar në defansivë. Ai ka thënë se sukses i diplomacisë së Kosovës konsiderohet parandalimi i tërheqjeve të njohjeve. "Politika e jashtme e Kosovës ka kaluar në defansivë dhe është reduktuar në aktivitete për përmirësimin e imazhit të Thaçit. Krejt shërbimi diplomatik i Kosovës është vënë në funksion të përmirësimit të imazhit të tij personal. Televizioni publik, 'RTK'-ja, veç sa nuk ka hapur një kanal të veçantë për aktivitetet e Thaçit. Disa vende kanë dhënë shenja se do ta rishqyrtojnë njohjen e Kosovës. Nuk bëhet fjalë për njohje të reja. Sukses sot i diplomacisë së Kosovës konsiderohet parandalimi i tërheqjeve të njohjeve", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se diplomacia e Kosovës duhet të kthehet në funksion të shtetit të Kosovës. "Ministri i Jashtëm përflitet për pjesëmarrje në borde të ndryshme krahas personaliteteve të dyshimta ruse. Kjo është diplomacia e kryeministrit Haradinaj dhe kryeparlamentarit Veseli, si dy partnerët kryesorë të koalicionit. Komprometimi më tutje i shtetit të Kosovës duhet të ndalohet sa më parë. Diplomacia e Kosovës duhet të kthehet në funksion të shtetit të Kosovës. Ata që i duan të mirën këtij vendi duhet të bëhen bashkë dhe ta mbështesin LDK-në dhe partnerët e saj për ta ndaluar degradimin e shtetit të Kosovës", ka shkruar Hoti.

# Mostransparenca në prokurimin publik rrit dyshimet për korrupsion




Jeton Zulfaj, menaxher i programeve nga Lëvizja FOL, ka thënë se raporti është një përmbledhje e raportit vjetor të monitorimit të prokurimit publik në tri ministritë: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. "Gjithashtu, ky raport përmban një freskim të analizës ligjore nga viti 2016 duke sjellë rastin e Estonisë dhe analizën e rëndësisë së hapjes së planifikimit të prokurimit publik në Kosovë", ka thënë Zulfaj, duke shtuar se Ligji për shoqëritë tregtare ende nuk është ndryshuar.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 MAJ - Lëvizja FOL ka mbajtur të martën tryezën e radhës, në të cilën është diskutuar raporti "Transparenca në prokurimin publik në Kosovë". Panelistë në këtë tryezë ishin Osman Bytyqi nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Agim Sheqiri nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), Mursel Racaj nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe zyrtarë të prokurimit nga ministritë si dhe përfaqësues të medieve dhe të organizatave joqeveritare.

Jeton Zulfaj, menaxher i programeve nga Lëvizja FOL, ka thënë se raporti është një përmbledhje e raportit vjetor të monitorimit të prokurimit publik në tri ministritë: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. "Gjithashtu, ky raport përmban një freskim të analizës ligjore nga viti 2016 duke sjellë rastin e Estonisë dhe analizën e rëndësisë së hapjes së planifikimit të prokurimit publik në Kosovë", ka thënë Zulfaj, duke shtuar se Ligji për shoqëritë tregtare ende nuk është ndryshuar. "Është me rëndësi që ky ligj të ndryshohet në atë kuptim që të ofrojë shumë informata se kush janë ata persona që përfitojnë prapa këtyre bizneseve. Është evidente që persona të caktuar mund të jenë të lidhur me ata që përfitojnë nga tenderët publikë. Gjithashtu, zyrtarët e prokurimit janë të cenueshëm ndaj korrupsionit dhe duhet edhe ata t'i nënshtrohen deklarimit të pasurisë", ka thënë Zulfaj.

Sipas tij, nga gjetjet e monitorimit të FOL-it del se ka mospërputhje të publikimeve të të dhënave në mes uebfaqeve të KRPP-së dhe platformës E-Prokurimi, tek njoftime për kontratë, njoftime për dhënie të kontratës dhe njoftimeve për nënshkrim të kontratës.

Osman Bytyqi nga Komisioni i Rregullativ i Prokurimit Publik tha se pajtohet me shumë nga të gjeturat e FOL-it. "Ligji nuk ka hyrë në agjendë legjislative për këtë vit, mirëpo na kanë premtuar se do të hyjë në agjendë vitin e ardhshëm dhe ne jemi pjesë e grupit punues dhe besoj seë kontratat do të bëhen shumë shpejt publike", është shprehur Bytyqi.

Ndërkaq Agim Sheqiri nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka thënë se baza aktuale ligjore është shumë e mirë, mirëpo duhet fokusuar tek qëndrueshmëria e projekteve. "Ne gjatë këtij viti duhet të përqendrohemi nga prokurimet e qëndrueshme. Pra, kur shtrojmë një rrugë të jetë e qëndrueshme dhe afatgjatë. Ne jemi dëshmitarë se ndonjëherë punët nuk po kryhen mirë. Blejmë makineri, por nuk janë të qëndrueshme. Dalin ministrat inaugurojnë projekte, por ato nuk përfundojnë sepse ka mungesa në sistem", ka thënë Sheqiri, duke shtuar se ka raste që një pronar qëndron prapa 2-3 kompanive të tjera.

Kurse Mursel Racaj nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (APQ) ka thënë se kjo agjenci ka filluar ngritjen e prokurimeve qendrore, mirëpo rritja e kësaj liste po del të jetë shumë sfiduese shkaku i mungesës së zyrtarëve të prokurimit në AQP. "Përveç kësaj, problem po del të jetë edhe monitorimi dhe zbatimi i kontratave në praktikë. Përgjegjësia më së shumti u bie zyrtarëve përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e kontratave. Andaj, ju inkurajoj të bëni më shumë në zbatimin dhe monitorimin e kontratave", ka deklaruar Racaj.

# Guvernatori Mehmeti merr mbështetje nga presidenti i BaFin-it



PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, gjatë vizitës zyrtare në Bonn dhe Frankfurt të Gjermanisë, ka takuar presidentin e Autoritetit Federal Mbikëqyrës Financiar (BaFin), Felix Hufeld. Në këtë takim guvernatori Mehmeti e ka informuar presidentin e BaFin-it, Hufeld, lidhur me zhvillimet e fundit në sistemin financiar në përgjithësi dhe sektorin bankar në veçanti.

Guvernatori Mehmeti ka shprehur falënderimet më të sinqerta për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që BaFin-it dhe Qeveria e Gjermanisë i kanë dhënë BQK-së dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi, me shpresën se ky bashkëpunim dhe përkrahje do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana tjetër, presidenti i BaFin-it, Felix Hufeld, ka uruar guvernatorin Mehmeti për përzgjedhjen në pozitën e guvernatorit të BQK-së duke i uruar mirëseardhje në BaFin dhe e ka siguruar atë për përkrahje dhe bashkëpunim të mëtejmë mes të dy autoriteteve.

# Qeveria miraton statutin për 'Trepçën'




PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Sipas Ligjit për Trepçën, si dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Qeveria e Kosovës ka aprovuar të martën propozimin nga Bordi Mbikëqyrës për Statutin e Shoqërisë Aksionare "Trepça" Sh. A. Statuti përcakton themeluesit, aksionet e tyre, veprimtarinë, strukturën organizative, kapitalin themeltar, menaxhimin, afarizmin, si dhe çështje të tjera organizative specifike të "Trepça" Sh.A.

Statusi përcakton Qeverinë e Republikës së Kosovës pronare të 80 % të aksioneve, kurse pronarë të 20 % të aksioneve do të janë punëtorët sipas Ligjit për Trepçën. "Trepça" Sh. A. themelohet me transformimin e njësive biznesore: 1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; 2. Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë; 3. Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviq.

Bazuar në studimin e qëndrueshmërisë dhe arsyetimin ekonomik e financiar, në përbërje të "Trepça" Sh. A. do të formohen edhe këto njësi biznesore: 1. Metalurgjia e plumbit; 2. Metalurgjia e zinkut; 3. Industria kimike.

Miratimin e statutit të "Trepça" Sh. A. kryeministri e ka vlerësuar ngjarje të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Pas miratimit nga Qeveria, statuti i shoqërisë aksionare "Trepça" Sh. A. dërgohet në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim dhe aprovim.

# Nënshkruhet marrëveshja 80 milionë euro për autostradën Kijevë - Zahaq



PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Ministri i Financave (MF), Bedri Hamza dhe zëvendëspresidenti i Bankës Evropiane për Investime (BEI), Dario Scannapieco, kanë nënshkruar të martën në Luksemburg marrëveshjen e huas për financimin e projektit për autostradën Prishtinë - Pejë, segmenti Kijevë - Zahaq, në vlerë prej 80 milionë eurosh. "Projekti për autostradën Prishtinë - Pejë, segmenti Kijevë - Zahaq, është një ndër prioritetet qeveritare që do t'u ndihmojë qytetarëve të Kosovës, me theks qytetarëve të Dukagjinit, por që është më e rëndësishmja përveç që do ta lidhë Kosovën me shtetet e tjera evropiane do të ketë edhe ndikim në zhvillim ekonomik të vendit. Kjo është marrëveshja e dytë financiare që po nënshkruhet për këtë projekt, pas asaj me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) tanimë e ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës. Përveç dy kredive, për këtë projekt janë përfituar grante nga korniza investuese e Ballkanit Perëndimor", është thënë në njoftimin e MF-së.

Sipas këtij njoftimi, ministri Hamza ka thënë se ndihet i lumtur për bashkëpunimin e arritur me Bankën Evropiane për Investime. "Jam shumë i lumtur që Kosova ka arritur këtë fazë të zhvillimit të përgjithshëm që ta thellojë edhe më shumë bashkëpunimin me Bankën Evropiane për Investime përmes kësaj marrëveshje shumë të madhe financiare, por shumë domethënëse për shtetin dhe për Bankën Evropiane për Investime. Qeveria e Kosovës e konsideron Bankën Evropiane për Investime si një partner strategjik për zhvillim dhe integrim evropian, gjë që do të reflektohet edhe përmes investimeve tona të përbashkëta në sektorë të tjerë", citohet të ketë thënë Hamza.

Ndërsa zëvendëspresidenti i Bankës Evropiane për Investime (BEI), Dario Scannapieco, ka thënë se kjo marrëveshje dëshmon më së miri sesa janë të përkushtuar që të jenë në Kosovë me trendë shumë të mira makro fiskale. "Banka Evropiane për Investime ka ndarë për Kosovën 257 milion euro, prej të cilave deri më tani janë nënshkruar 149 milionë euro marrëveshje financiare", ka thënë Scannapieco.

Gjatë vizitës në Luksemburg, ministri Bedri Hamza pritet të takojë edhe përfaqësues të tjerë të nivelit të lartë të Bankës Evropiane për Investime për të diskutuar për progresin e projekteve aktuale në Kosovë dhe për mundësitë e financimit të projekteve potenciale për Kosovën, me theks të veçantë për sektorin e mjedisit, shëndetësisë dhe sektorin privat.

# Fillon identifikimi i produktit turistik në Kaçanik

KAÇANIK, 29 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka pritur të martën në takim përfaqësues të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MT) nga sektori i turizmit, Xhemajl Pllana, udhëheqës i divizionit të turizmit si dhe Hysen Sogojeva, përgjegjës për hoteleri dhe standarde turistike. Në këtë takim është diskutuar për nismën e MTI-së për identifikimin e produktit turistik në rajone të ndryshme të Kosovës. Kryetari Ilazi ka theksuar nevojën e investimeve në Kaçanik në sektorin turistik, ndërsa ka shprehur përkushtimin institucional për bashkëpunim të mëtutjeshëm me MTI-në. Edhe nënkryetari i Kaçanikut, Ylber Bajra, ka thënë se kjo komunë ka nevojë për përkrahje pasi, sipas tij, ka resurse të shëndosha turistike dhe i plotëson të gjitha kushtet për zhvillim turistik.





# Hapet për qarkullim rruga Prishtinë - Hani i Elezit

PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka marrë vendim për lejimin e qarkullimit rrugor për automjete në rrugën nacionale N2, segmenti Kaçanik - Hani i Elezit, në të cilën ishte ndaluar qarkullimi si pasojë e rrezikut të madh nga rrëshqitjet e mëdha të dheut dhe gurëve. Pas ndërhyrjes në sanim të dëmit dhe evitim të rrezikut, nën mbikëqyrjen e ministrit Pal Lekaj me bashkëpunëtorë, kjo rrugë është lëshuar të martën për qarkullim rrugor. "Sot po e shihni edhe vetë që është bërë sanimi i kësaj rruge, e që është me rëndësi të veçantë për lidhjet e korridoreve", ka thënë Lekaj, duke shtuar se ministria që drejton është duke punuar në çdo rrugë aty ku ka probleme infrastrukturore.



# Ferizaj bëhet gati për 'Ditët e Kulturës'

Ferizaj, 29 maj (ER) - Në Komunën e Ferizajt sot (e mërkurë) do të fillojnë "Ditët e Kulturës Ferizaj 2018", një eveniment i kulturës i cili për disa ditë para ferizajasve do të ofrojë shumë aktivitete kulturore. Këto aktivitete organizohen nën përkujdesjen e kryetarit të Ferizajt, Agim Aliu. Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Xhemile Murati-Shabani, ka thënë se hapja solemne e "Ditëve të Kulturës" do të bëhet me Festivalin e Fëmijëve "Fëmijët e gëzuar".
Ky festival do ta shënojë edhe 30-vjetorin e themelimit. "Artdashësit dhe dashamirësit e kulturës kanë një rast të mirë të njihen me rrjedhat e krijimtarisë kulturore dhe t'i shijojnë ato vlera që po krijohen në këtë mjedis", ka thënë Murati-Shabani.
Ndërsa drejtori i festivalit "Fëmijët e gëzuar", Nazmi Aliu, ka bërë me dije se në këtë festival konkurrenca ka qenë e jashtëzakonshme, ndërkaq nga juria profesionale janë zgjedhur edhe këngët konkurruese. Manifestimi "Ditët e kulturës" do të mbahet deri më 12 qershor.

# Inspektohen punimet në sheshin e qytetit të Klinës

KLINË, 29 MAJ (ER) - Punimet e sheshit në qytetin e Klinës janë në përfundim e sipër. Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, Petrit Bekaj, ka dalë në terren për të parë nga afër se si po ecin këto punime. Ai ka shprehur optimizëm se shumë shpejt do të përfundojnë punimet në ndërtimet e këtij sheshi. "Deri më tash punimet po ecin mirë dhe besojmë se shumë shpejt do të përfundojnë. Ne si drejtori duhet të shohim nga afër se si është duke u zhvilluar puna. Përveç sheshit është duke u rregulluar edhe pjesa e taksistëve, në mënyrë që qyteti të ketë sa më shumë hapësirë", ka theksuar Bekaj.



# Drenasi nis zbatimin e projektit për 'trajtimin e qenve endacakë'

DRENAS, 29 MAJ (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Komunën e Drenasit ka filluar implementimin e projektit "Trajtimi i qenve endacakë".
Drejtoresha e kësaj drejtorie, Lumnije Krapi, ka theksuar se këtë vit ky projekt do të implementohet nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AVUK), e cila ka kontraktuar subjektet veterinare për trajtimin e qenve endacakë, të cilët janë të ndarë sipas regjioneve në kuadër të cilave përfshihen të gjitha komunat e Kosovës.
Në regjionin e Prishtinës përfshihet Komuna e Drenasit, ku është kontraktuar subjekti veterinar "A. V Drenas", me seli në Drenas.



# Hashim Thaçi kryenegociator!



Ylber ÇITAKU

Opozita tash e sa muaj ka marrë yryshin për ta kundërshtuar personin kyç të dialogut Kosovë - Serbi, Hashim Thaçin. Këtu mund të shtrohen shumë pyetje logjike, por unë po i parashtroj tri:

1. A është koha të merret ky yrysh?

Përgjigjja ime është jo.

Opozita po provon ta ngrehë kauzën e frikës nga lëshimet e mundshme të z. Thaçi në raport me Serbinë. A e kapur mendja e shëndoshë këtë kauzë!? Si ka mundësi të bëjë lëshime njeriu që punoi më shumë se gjithë opozita bashkë për çlirimin e Kosovës nga Serbia.

Nëse e marrim sikur është dikush tjetër udhëheqës i bisedimeve, hipotetikisht një njeri me ndjenja krejt kundër Kosovës, lëshime të përmasave çfarë po ngre opozita nuk e lejon as faktori ndërkombëtar.

2. A ka të drejtë opozita që kundërshton Thaçin si udhëheqës të këtyre bisedimeve?

Përgjigjja ime është jo (po).

Jemi në vitin e fundit të dialogut Kosovë - Serbi, bisedime këto që do të rezultojnë me një marrëveshje, ku Kosova do të anëtarësohet në OKB dhe ky do të jetë suksesi më i madh i Kosovës dhe i popullit të saj pas çlirimit dhe shpalljes së pavarësisë, sukses ky që do të arrihet prapë nën udhëheqjen e z. Thaçi, e që rrjedhimisht opozita (ose një pjesë e saj) do të mbetet në pozicionin e opozitës së paku edhe për disa vjet.

Arsyeshëm opozita ngre paranojën se rezultati i këtij suksesi atyre u siguron opozitarizëm me dekada.

3. A është me të vërtetë Thaçi burrështetas i përmasave të Xhorxh Uashingtonit siç thoshte zëvendëspresidenti Joe Biden që me gjenerozitet thërret opozitën t'i bashkohen delegacionit?

Përgjigjja ime është jo (po).

Thaçi gjeneroz? Duke e parë dhe duke e njohur injorancën dhe budallallëkun e opozitës (ose të një pjese të saj), Thaçi është i vetëdijshëm se ky gjenerozitet dhe këto merita rrjedhimisht bien mbi të, por që thotë fjala e urtë popullore "dardha ka bisht". Z. Thaçi në vitet në vijim do të tallet me ta duke u thënë: "Ishit kundër luftës (sikur që ishin), ishit kundër Rambujesë (sikur që ishin), ishit kundër presidentit Ahtisari (sikur që ishin), ishit skeptikë për pavarësinë, madje për vite të tëra e përbuzët (siç edhe e përbuzën dhe ende e përbuzin), ishit kundër anëtarësimit të Kosovës në OKB (sikur që do të dalë që janë) jo që nuk e duan Kosovën anëtare të OKB-së, por janë të prirë të kundërshtojnë gjithçka progresive e ku ata nuk janë prijatarë". Kujto fjalën popullore "Për inati të resë, më vdektë djali!"

Për fund, pyetjet e parashtruara më lart nuk kanë marrë për bazë nenin 4, pika 3, si dhe nenin 84, pikat 1, 7 dhe 10 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nene e pika këto që e detyrojnë presidentin e vendit, në këtë rast z. Thaçi, të jetë nënshkrues i marrëveshjes përfundimtare me Serbinë nën garancinë e bashkësisë ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e opozitës në sinkronizim edhe me disa elementë nga përbërja e mozaikut qeveritarë deklarohen se një personalitet X, personalitet ky fantazmë në imagjinatën e tyre, duhet të jetë kryenegociator e dikush tjetër (në këtë rast z. Thaçi) të nënshkruajë marrëveshjen ndërkombëtare sipas pikës 7 të nenit 84 të Kushtetutës.

Për të gjithë këtë, politikanët që shtyjnë këtë ide përpara, e pakta çka mund të thuhet për ta është se me ose pa dashje çojnë ujë në mulli të djallit ose janë injorantë në katrorë.

# Rinia e Kosovës ka potencial të veçantë



**Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka pritur të martën në takim ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, me të cilën ka diskutuar rreth angazhimeve të kësaj ministrie dhe bashkëpunimin që MRKS-ja ka pasur me Ambasadën e Finlandës në Kosovë**

PRISHTINË, 29 MAJ (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, gjatë takimit me ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, kanë biseduar rreth koordinimit të përbashkët për fushën e rinisë. Me këtë rast, ministri Gashi ka falënderuar ambasadoren finlandeze dhe nëpërmjet saj Qeverinë dhe popullin e Finlandës për ndihmën dhe mbështetjen që kanë dhënë për shtetin e Kosovës.

Gashi e ka informuar ambasadoren se MKRS-ja është duke e finalizuar Strategjinë e re për rininë, përmes së cilës i kushtohet vëmendje e posaçme këtij grupi të madh shoqëror, duke e pasur parasysh faktin se pjesa më e madhe e shoqërisë sonë janë të rinjtë. "Për herë të parë në këtë strategji do të përfshihet Fondi për rini dhe në kuadër të këtij fondi mund të kemi bashkëpunim të ngushtë me ambasadën sepse parashihen disa programe për të rinj, siç janë shkëmbimet rinore dhe përvojat e tyre mes shteteve të ndryshme. Në kuadër të strategjisë kemi përfshirë edhe komponentin e luftës kundër ekstremizmit", ka thënë Gashi.

Po ashtu, ministri Gashi e ka njoftuar ambasadoren finlandeze Stjernvall, se MKRS-ja mbështet të rinjtë në projekte të ndryshme përmes subvencionimit të drejtpërdrejtë, ndër ta, ndërmarrësit e rinj si dhe projektet e ndryshme inovative. "Gjithashtu, për herë të parë në Kosovë do të fillojë projekti i ndërtimit të Qendrës Mutlifunksionale për Rini, i cili është një model nga ShBA-ja", është shprehur Gashi.

Ndërsa ambasadorja Pia Stjernvall ka vlerësuar se rinia e Kosovës ka një potencial të veçantë.

Edhe ajo e ka njoftuar ministrin Gashi se në Finlandë kur hartojnë dokumente të ndryshme strategjike, fokus primar i kushtojnë rinisë, më pas marrëdhënieve ekonomike dhe bashkëpunimit e stabilitetit rajonal. "Ne si ambasadë kemi kapacitet të krijojmë lidhje mes rinisë së Finlandës dhe rinisë së Kosovës. Kemi pasur vizita nga Finlanda në Universitetin e Prishtinës dhe në UBT. Ende nuk e kemi të qartë cilat projekte do t'i realizojmë bashkërisht, mirëpo jemi këtu që të diskutojmë rreth një bashkëpunimi më konkret. Ne në ambasadë do të ftojmë të rinj që të bashkëbisedojmë për gjërat që janë në interes dhe në prioritetin e tyre", ka deklaruar ambasadorja Stjernvall.

# TMERRI I PRISHTINËS, TMERRI I BLLACËS DHE TMERRI I DËSHTIMIT TONË POLITIK



MILAZIM KRASNIQI

Kush do ta mendonte atë ditë të 23 marsit 1999 derisa profesor Fehmi Agani po na jepte udhëzimet e fundit, se nga ajo ditë e tutje do të përmbyseshin jo vetëm raportet, por edhe fatet tona, të disave, si ai i profesor Fehmiut, edhe tragjikisht. Atë pasdite profesor Fehmiu rrinte me njërën këmbë në tokë e me tjetrën në ajër, mbi një cep të tavolinës së gjatë në formë T-je, paksa i gërmuqur dhe i kthyer drejt ballit të tavolinës kryesore, ku po rrinin Kolë Berisha dhe afër tij disa anëtarë të tjerë të kryesisë, që nuk e mbaj mend se cilët ishin. Profesor Fehmiut në fytyrë i lëvarej ajo buzëqeshja e moçme, një buzëqeshje që ishte shoqëruese e çuditshme e tij. Po fliste me një zë të ulët por, pothuajse, me gjallëri. Për ata që e njihnin stilin e tij të komunikimit mund të dukej i disponuar. Ai po tregonte për takimin e fundit që ai, bashkë me Edita Tahirin e me Blerim Shalën, kishin pasur me Vesli Klarkun në Monsë, pas përfundimit të Konferencës së Parisit. Po e madhështonin udhëzimet e fundit, që po na i jepte para 24 marsit. Ai parafrazoi konkluzionin e Klarkut, sipas të cilit, do të ndodhnin bombardimet e NATO-s, pasi që nuk kishte shenja të tërheqjes së Millosheviqit. Pastaj, përcolli sugjerimin e Klarkut, se bombardimet do të mund të zgjasnin dy-tre ditë dhe se për ato ditë nuk ishte e preferueshme të dilnim në rrugë, meqë mund të ndodhnin ngacmime ose sulme nga ana e fanatikëve serbë. Nga këto fjalë të gjithë u ndiem të lehtësuar, sepse rezultonte që e gjitha do të zgjaste shkurt dhe nuk do të kishte pasoja të mëdha. Pas atyre fjalëve ishte e qartë se qëndrimi politik që do të mbahej, do të ishte i mbështetur në ato vlerësime. Mbaj mend se e pyeta për marrëveshjen për formimin e qeverisë së përbashkët. Ai zuri të qeshte gati në mënyrë të pakontrolluar, e mbajti gojën me dorë një copë herë, pastaj tha se ajo kishte qenë vetëm një hajgare.

Pas atij takimi joformal unë komunikova me disa kryetarë të komisioneve për informim në terren dhe, pak a shumë, u dhashë po ato udhëzime që na i dha neve profesor Fehmiu. Pastaj shkova në redaksinë e gazetës, redaktova disa tekste që duhej të dërgoheshin në redaksinë qendrore në Cyrih. Të gjithë në redaksi rrinin të heshtur dhe të hutuar. Më shumë shikonin përdhe sesa njërin tjetrin, si të qenë të gjithë të zënë në faj. Punën e mbyllëm më herët se zakonisht, pasi nuk kishte raportime nga terreni. Gjithçka ishte shndërruar në pritje. Beqa më dërgoi me veturë deri te hyrja e banesës, meqë ato ditë ndihesha më i kërcënuar.

Të nesërmen nuk dola në redaksi. U dhashë disa udhëzime kolegëve me telefon dhe ndenja në banesë tërë ditën. Më vonë mora vesh se në redaksi ishte përhapur fjala që isha larguar nga Kosova në drejtim të Maqedonisë. Por, kur fola me Beqën, i tregova se gjendesha në banesë dhe se nuk kisha asnjë plan largimi. Dita iku shpejt dhe gjatë tërë mbrëmjes u përfshiva nga emisione lajmesh, që flisnin për mundësinë e bombardimeve, pasi që Kuvendi i Serbisë kishte miratuar një dokument, ku e fuqizonte politikën e Milloshevigit. Pas emisionit qendror të lajmeve të RTS-së isha në pritje të lajmeve të "Zërit të Amerikës". Disa minuta pas orës njëzet u dëgjua një eksplodim në largësi. Pas pak u dha lajmi se bombardimet e NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe kishin filluar. Unë nuk po e frenoja gëzimin, ndërsa Edibja më shikonte e hutuar dhe më tha:

- Pse po gëzohesh? Tash mund të na vrasin krejtve.

U mundova ta qetësoja, por ajo ishte aq kokëfortë në idenë e saj, saqë u detyrova ta braktisja përpjekjen time. Nga biseda jonë m'u bë e qartë se Teuta e Bubulina ishin të hutuara e të frikësuara. I mora pranë vetes dhe fillova t'u tregoja disa përralla, disa që më kujtoheshin nga fëmijëria ime e disa thjesht të improvizuara. Ato u qetësuan dhe ranë për gjumë.

Afër mesnatës unë rashë për gjumë, i disponuar. Edhe fjeta mirë deri në mëngjes. Kur u zgjova Edibja ishte zgjuar dhe e frikësuar edhe më shumë. Më tha se nuk kishte futur gjumë në sy nga frika se çfarë do të na ndodhte. Prapë u mundova ta qetësoja, por prapë ishte e kotë. Ajo ishte e bindur se do të kishte vrasje dhe shkatërrime të mëdha. Unë, duke u bazuar në vlerësimet që na i kish përcjellë profesor Fehmiu, isha këmbëngulës se e tëra nuk do të zgjaste shumë dhe se nuk do të kishte pasoja të mëdha.

Rreth orës 8.00 më thirri në telefon Sylë Hoxha, sekretar i Degës së LDK-së në Prizren. Me zë të mbytur më tha se natën e kishin sulmuar bandat familjen e Eqrem Kryeziut, se ia kishin plagosur vajzën dhe Eqremin, me gjasë, e kishin vrarë. Ai më porositi ta lajmëroja Nekibe Kelmendin për atë që kishte ndodhur në Prizren. Unë menjëherë e formova numrin e Nekibes. M'u lajmërua një zë gruaje, më tha se ishte e reja. Ajo me një zë krejtësisht të flashkët më tha shkurt, se Nekibja nuk ishte në shtëpi, meqë kishte shkuar të informohej se çfarë po ndodhte me Bajramin dhe të dy djemtë që i kishin arrestuar natën. Kjo për mua ishte si një bombë që të shpërthen në afërsi. Pas nja dhjetë minutash, derisa unë ende nuk po vija në vete nga tronditja, më thirri im vëlla, Izedini. Edhe ai foli shkurt dhe me një zë të mbytur. Ai më tregoi se bandat serbe e kishin vrarë natën profesor Latif Berishën, kryetarin e Degës së LDK-së në Mitrovicë dhe Agim Hajrizin, njërin nga liderët sindikalistë të Kosovës. Pas kësaj informate e kuptova se ishim në kurth. E kuptova qartë se nuk ishte puna ashtu siç na tha profesor Fehmiu dy ditë më parë në selinë e LDK-së, që të mjaftoheshim duke mos dalë në rrugë. Bandat e uniformuara të policisë serbe kishin hyrë nëpër shtëpi dhe kishin vrarë e kidnapuar personalitete të njohura. Eqremin e kisha njohur për herë të parë në ditën e themelimit të Degës së LDK-së në Prizren. E pata bindur, jo pa vështirësi, që të bëhej kandidat për kryetar dhe e pata favorizuar shumë që të zgjidhej kryetar, përballë një kundërkandidati që e kishte organizuar tubimin themelues dhe e kishte përgatitur ambientin që vetë të bëhej kryetar. Prej ditës kur Eqremi u zgjodh kryetar, kemi pasur muhabet, megjithëse më shumë për tema intelektuale sesa politike. Ai ishte i prirë pak drejt disa ideve mistike, që nga ato indase e deri tek ato të sekteve myslimane, gjë që bisedat i mbushte me emocione dhe ballafaqim mendimesh. Na pati ndodhur një rast që të rrinim mysafirë në Prizren tek disa miq tanë të përbashkët dy net duke zhvilluar asi debatesh të hallakatura. E pata nxitur t'i rikthehej edhe studimit të letërsisë, duke i kërkuar tekste për t'ia botuar te revista "Fjala". Nga fundi i vitit 1998 dhe fillimi i vitit 1999 ai vinte gjithnjë e më rrallë në Prishtinë. Tash që po e dija për të vrarë, nuk e kujtoja dot takimin e mbrëmshëm me të.

Profesor Latif Berishën e kam pasur mësimdhënës në fakultet dhe bëja pjesë në atë grup njerëzish, të cilët e respektonin për qetësinë dhe mirësjelljen e tij. Pamja e tij markante nuk më shqitej nga mendja. Por, në përfytyrimin e çasteve të fundit të jetës së tij, më dukej se e shihja kur dilte ta hapte portën, se si fillonte e zvogëlohej dhe ngadalë humbte pamja e tij në errësirë. Avokatin Bajram Kelmendi e njihja më pak, meqë me të nuk më kishte rastisur të rrija shumë. E mbaja mend se kur ishim në grevën e urisë të gazetarëve në pallatin e "Rilindjes", në vitin 1993, ai vinte çdo natë, rrinte me ne një copë herë dhe recitonte vargje të Gjergj Fishtës. Pinte duhan me llullë. Mirëpo, unë e njihja më shumë gruan e tij, Nekiben, e cila ishte sekretareshë e partisë sonë. Me të kishim bashkëpunim shumë të mirë. Djemtë e tyre nuk i njihja, sikundër që nuk e njihja as Agim Hajrizin dhe të birin e tij. Por, tronditja edhe për ta ishte e madhe.

Në atë ankth e dëgjuam kur u hap dera e garsonierës që kishim pranë, ku banonte një i njohur yni, Naseri, me të fejuarën e tij. E hapëm derën dhe u përshëndetëm me Naserin. Ai dukej i shkujdesur. E pyeta se si ishte gjendja në qytet. Ai tha se ishte e zakonshme. E pyeta se a mund të dilja unë dhe të shkoja me të deri tek ime motër, në lagjen Vellusha. Nëna e Naserit ka qenë ndrikulla e fëmijëve të motrës sime dhe ai ishte i familjarizuar me familjen e saj. Naseri na tha se nuk kishte ndonjë problem dhe se mund të shkonim bashkë. Unë ende po hezitoja, por Edibja nguli këmbë të largoheshim menjëherë nga banesa jonë e të shkonim atje. U bëmë gati shpejt. Nuk morëm pothuajse asgjë me vete, për të mos rënë në sy. Sapo dolëm nga banesa u takuam ballë për ballë me një fqinjin tonë serb, një djalë i ri të cilit as emrin nuk ia dija. Ndonëse shumë i ri, ai atë ditë ishte me uniformë ushtarake. U shikuam të hutuar, pa u përshëndetur. Pastaj, me Naserin kaluam nëpër oborrin e Çerdhes së Fëmijëve "Gëzimi Ynë" pranë banesës sime dhe dolëm te udhëkryqi, që është poshtë Mensës së Studentëve. Disa vetura udhëtarësh dhe disa autoblinda shkonin e vinin, por jo edhe aq shumë. Njerëz në rrugë nuk kishte. Ecëm nëpër rrugën "Ramiz Sadiku", por Naseri më tha se duhej të ndalej në banesën e Meli Qenës, ku ishte e fejuara e tij, së cilës duhej t'ia dërgonte disa gjëra që kishte marrë në garsonierë. Aty ku hymë banonin jo pak familje serbe. Menjëherë vura re se në ballkone rrinin nga dy ose tre njerëz, që e vrojtonin rrugën. Derisa unë po prisja në rrugë, më cingëroi celulari. Ishte gazetari Xhavit Beqiri, që po interesohej ku isha dhe çfarë po bëja. I thashë shkurt se jam në rrugë dhe e mbyllëm bisedën. Naseri u kthye shpejt dhe ne morëm disa rrugica e dolëm te parku i qytetit. Para hotelit "Park", i cili ishte një shtëpi publike, që e administronte një serb, të cilin e quanin Bata, po rrinin dy serbë, punëtorë a klientë. Na shikuan si të çartur, por nuk folën asgjë. Ne hymë në rrugën Vellusha dhe pas disa minutash mbërrita para shtëpisë së motrës sime. U ndiem të lehtësuar.

Në atë shtëpi unë kisha jetuar me vite. Në fakt, ajo ishte shtëpia ime e dytë. Motra ime, Fatimja, ka qenë nga ato motra që edhe e kanë formësuar simbolin e motrës së përkushtuar deri në flijim për vëllain. Aq e përkushtuar, e dashur dhe modeste, mund të jetë vetëm një grua e ndershme, një besimtare e devotshme. Kurrë në jetën time nuk kam parë mërzi në sytë a në fytyrën e saj. Mbase për këtë arsye, në ditën kur po ndërronte jetë, disa minuta para se të ndahej nga ne, i pati thënë motrës sime tjetër, Arifes:

- Si po i msheli sytë përpara po më dalin veç lule.

Kur dikush nga ne u mundua në ato çaste të fundit të jetës së saj, t'ia përkujtonte se duhej të thoshte shahadetin, ajo ia ktheu:

- Tanë kohën unë bie shahadet!

Në rastin e saj e kam parë më qartë se kudo tjetër, qetësinë dhe përgatitjen e njeriut për të shkuar nga kjo botë, pa frikë e pa mërzi. Jeta e saj ka qenë e përmbushur me shërbim ndaj burrit, ndaj fëmijëve, ndaj familjes së saj e familjes së të shoqit, ndaj mysafirëve të njohur e të panjohur, që me decenie derën e shtëpisë së vjehrrit të saj, Rrahmanit dhe të burrit të saj, Namanit, e kanë gjetur të hapur edhe në pikë të natës. Mikpritja e Namanit dhe e motrës sime, për ata që i kanë njohur, është pikërisht ashtu si përshkruhet mikpritja shqiptare në literaturën romantike.

Në shtëpinë e motrës sime gjetëm jo vetëm anëtarët e asaj familjeje të madhe, por edhe disa mysafirë të tyre. Megjithatë, mua m'u duk se disa nga njerëzit aty u hutuan kur më panë. Lajmet se ishin vrarë disa personalitete të njohura të LDK-së dhe të asaj që quhej "alternativa kosovare", i kishin ndërgjegjësuar se edhe figura të tjera të lëvizjes shqiptare mund të ishin cak i hakmarrjes së shtetit serb. Në fakt, ata kishin të drejtë në drojën e tyre, por unë më nuk kisha ndonjë zgjidhje tjetër.

Po të mbetesha në banesën time, puna mund të shkonte ters. Të nesërmen e asaj dite, fqinja jonë, Sanija, e lajmëroi me telefon Ediben se atë natë, rreth orës 21.00, në derën e banesës sonë kishin ardhur disa policë, e kishin rrapëlluar derën, kishin pritur që ajo të hapej, pastaj kishin folur me dikë me toki-voki, duke bërë pyetjen: "Sta da radimo?" (Çka të bëjmë?) e pas një kohe ishin larguar. Sanija i

kishte dëgjuar bisedat e tyre, e fshehur prapa derës së banesës së vet, e cila është përballë sonës. Tash po na njoftonte që ta dinim se policia kishte qenë në derën tonë.

Por, me telefonatat që bëheshin, veçmas pas masakrës ndaj familjes së gruas sime, në fshatin Bellacërkë të Rahovecit ishte e zorshme të ruhej konfidencialiteti i strehimit tonë. Në mëngjesin e datës 25 mars forcat serbe kishin hyrë edhe në fshatin Bellacërkë të Rahovecit dhe kishin vrarë rreth shtatëdhjetë banorë të fshatit, të gjithë civilë. Në mesin e të vrarëve ishte edhe babai i Edibes, Hysni Zhuniqi, pastaj dajallarët, Sedati dhe Irfani, kushërinj dhe djem dajallarësh, që të gjithë së bashku rreth dyzet, nga rreth shtatëdhjetë që ishin vrarë në atë fshat dhe në të njëjtin vend. Tragjedia bëhej edhe më e madhe pasi që disa prej tyre, në mesin e të cilëve Hysniut, Sedatit e Irfanit, nuk u ishin gjendur trupat. Dhembja e madhe për humbjen e tyre ishte shumëfishuar edhe nga fakti se nuk dihej se ku ishin trupat e tyre. Një numër i pafund bisedash telefonike me njerëz të farefisit të Edibes që gjendeshin në Zvicër, në Gjermani e gjithandej në Evropë, përshkonte ditët e zymta e netët e trishtuara të atij fundmarsi. Ishte e pakuptimtë të thuhej se duhej bërë kujdes e të mos jepeshin të dhëna se ku gjendeshim, në vorbullën e gjithë asaj tragjedie që kish ndodhur me farefisin e saj. Të gjithë ishin në siklet me të drejtë nga kjo punë.

Netët në shtëpinë e Namanit, ku qemë mbledhur më shumë se tridhjetë njerëz, ishin të trishtuara. Fëmijët dhe gratë flinin që të gjithë në bodrum, i cili ishte i parregulluar për banim. Ndërsa, disa nga burrat bënim njëfarë roje në katin e dytë të shtëpisë. Kishim një qifte dhe një pushkë M48 me disa fishekë. Vetë ideja që të bëhej ajo roje ishte pothuajse absurde. Nëse do të shkrepej ndonjë plumb ndaj forcave që do të mund të hynin në shtëpi, ashtu rrezikohej jeta e të gjithëve. Por, në aso rrethanash të rënda, duket se as vendimet që merren nuk janë plotësisht racionale.

Në natën e 29 prillit, dy ditë para se të na dëbonin nga rruga Vellusha, unë po bëja vëzhgimin në katin e dytë të shtëpisë. Mund të ketë qenë ora rreth tre pas mesnatës. U habita pa masë kur pashë një grua të veshur me rroba të bardha, e cila ecte përmes rrugës, maste me sy shtëpitë, nganjëherë ndalej për disa çaste e pastaj ecte sërish, por ngadalë e si duke kërkuar ndonjë gjë të humbur. Meqë dritat e rrugës ishin në funksion, e dallova qartë se ishte një grua e hollë, zeshkane, me flokë të shkurtra. Nuk ia kisha idenë se çfarë po bënte e çfarë po kërkonte ajo grua në atë orë nate, në kushtet e orës policore dhe të luftës. Por, më 30 mars 1999, kur ushtarë rezervistë dhe policë hynë edhe në shtëpinë e Ismailit e të Selvetes, ku ne patëm kaluar dy net më parë dhe na nxorën me dhunë në rrugë, duke na kërcënuar se do të na vrisnin nëse nuk dilnim për pesë minuta, e pata të qartë ecejakun e asaj gruaje. Ajo ishte pjesë e ekipit të policëve dhe ushtarëve që po na dëbonin, ajo po u jepte kuotat se deri te cilat shtëpi duhej të ndërhynin për atë ditë, meqë dëbimi ishte sistematik, nga shtëpia në shtëpi, lagje më lagje. Atë person e kam portretizuar më vonë në dramën time "Bryma e vdekjes", duke e emërtuar "Gruaja shurdhmemece", një agjente e shërbimit sekret serb që bëhet edhe snajperiste dhe e vret një të ri të rebeluar në kampin e Bllacës. Roli i asaj gruaje në piketimin e shtëpive shqiptare që duhej të dëboheshin, (sepse në atë lagje kishte edhe shtëpi serbe, të cilat ajo natyrisht që i kishte markuar që të mos trazoheshin), është provë e një planifikimi të detajuar të dëbimit dhe të spastrimit etnik. Një eksperte e tillë, që i di shtëpitë e shqiptarëve e të serbëve, që planifikon me gjakftohtësi e me saktësi dëbimin, nuk mund të bëhet brenda katër-pesë ditëve, pas fillimit të bombardimeve të NATO-s ndaj caqeve ushtarake serbe.

Nga shtëpia e Ismailit e Selvetes neve na dëbuan pasditen e 30 marsit. Kur na nxorën nga oborri në rrugën Vellusha, ajo ishte e stërmbushur nga njerëz të dëbuar nga shtëpitë e mësipërme. Dëgjoheshin vaje e klithma të fëmijëve dhe zhurmërima e hapave të njerëzve që ecnin me kokë ulur, si të ishin të kurdisur të ecnin ashtu. Nga njerëzit që më ranë në sy menjëherë ishte Rexhep Boja. Ishte disa hapa para meje. Disa shtëpi nën objektin e Kryesisë së Bashkësisë Islame, në një shtëpi shpërthyen të qara fëmijësh e grash. Rruga që po na çonin ishte që të ktheheshim në të djathtë e të kalonin pranë shkollës "Vuk Karaxhiq", na nxorën te xhamia e Çarshisë e prej andej rrugës Dogrijoll e tutje te Stacioni i Trenit. Policët e ruanin turmën në të dyja anët, me tytat e drejtuara në turmë. Dëgjohej vetëm zhurmërima e hapave dhe urdhrat e policëve të armatosur. Kur na futën në hapësirat e Stacionit të Trenit, aty duhej t'i prisnim trenat që do të vinin e do të na depërtonin dikah. Askush nuk e dinte se nga do të na depërtonin. Kishte që thoshin se do të na depërtonin drejt Nishit. Në stacion kam parë Avni Spahiun e Alush Gashin, të topitur edhe ata si të gjithë ne të tjerët. Kur erdhi një tren, e gjithë turma u dynd drejt tij. Ne provuam të hynim po nuk arritëm dhe unë thashë të prisnim trenin tjetër, por Edibja insistoi të provonim prapë dhe disi arritëm të futeshim brenda. Ishte tmerr brenda, nga kallaballëku. Por, më mirë që të niseshim për diku sesa të rrinim natën në atë stacion, ku vigjilonin policë e civilë serbë të armatosur. Udhëtimi ishte i mundimshëm dhe i paharrueshëm, sepse po largoheshin me dhunë nga shtëpitë tona, nga qyteti ynë, nga vendi ynë.

Në Bllacë pamë tmerrin me sy. Aty ishim në një kamp përqendrimi, sepse nuk mund të dilnim prej tij, meqë ai ruhej nga forca speciale të policisë së Maqedonisë. Policët ishin shumë brutalë në komunikim, ishin sadistë, sepse kënaqeshin duke na parë se si vuanim. Në dramën "Bryma e vdekjes" e kam tematizuar vuajtjen njerëzore në këtë kamp si dhe brutalitetin e sadizmin e policisë së Maqedonisë. Vetëm pasi e kam shkruar atë dramë jam liruar nga ankthi që më shkaktonte kujtimi i kampit të Bllacës. Një policit i pata thënë se do t'ua përjetësoja turpin që po bënin duke na keqtrajtuar, kur edhe pa keqtrajtimin e tyre jetët tona ishin të shkatërruara në atë kohë. Se si erdhi puna që pas disa vitesh, m'u kërkua nga kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, që ta shkruaja një tekst përkujtues për kampin e Bllacës, i cili u vendos në një obelisk në zonën neutrale dhe i cili ende është po aty. Teksti është ky:

*"Kjo zonë ndërkufitare prej datës 25 mars 1999 deri më 7 prill 1999 ishte vendqëndrim i detyrueshëm për mijëra civilë shqiptarë, viktima të spastrimit etnik të ushtruar nga Serbia. Ata këtu u mbajtën në kushte ekstreme, aq sa vuajtjet e tyre u shndërruan në një katastrofë humanitare.*

*Bari që mbin nga toka edhe në këtë vend duhet ta ushqejë pajtimin, por koha që ecën nuk duhet ta zbehë as këtu kujtimin".*

Kampi i Bllacës ishte një përvojë unike në jetën time. Aty pashë për së afërmi vuajtjen e thellë të mijëra njerëzve me jetë të shkatërruara. Kurrë nuk e harroj pamjen e një fqinjit tim, Misimit, mësimdhënës matematike në fakultet, të cilin e pashë se si po përpiqej të ngrinte një shator të vogël plastike, duke përdorur gurin si mjet pune. Po e qëllonte me atë gur një hu të vogël, i gërmuqur. Edhe pse po e qëllonte me tërë fuqinë e vet, huri nuk po hynte në dhe, meqë nuk e kishte mprehur dhe guri nuk ishte mjeti i përshtatshëm për atë punë. Pra, e pashë me sytë e mi se si një mësimdhënës universitar kthehej në kohën e gurit, thënë figurativisht. Aty kam ndenjur me një këngëtar që qante dhe ishte i bindur se jeta e tij dhe e të gjithë neve ishte përfundimisht e shkatërruar dhe nuk ma vinte fare veshin kur i thosha se do të bëhej mirë. Në atë kamp ka vdekur profesori dhe patrioti i njohur Ahmet Mumxhiu, të cilin e respektonim të gjithë në lagje po dhe në tërë Prishtinën. Aty e kam parë me sytë e mi një djalë të ri se si u çmend dhe nga afër e kam shikuar gjithë dramën e familjes së tij, derisa vetë po përpiqesha ta ngrohja paksa Bubulinën, pranë një zjarri të ndezur në asfalt, sepse nga të ftohtit, nga pagjumësia dhe nga uria, faktikisht i ra të fikët dhe mezi u këndell. Aty kam ndenjur me kushëririn tim, Sejdiun, i cili kishte mbetur fillikat. Nuk e dinte as ku e kishte gruan, as djemtë, as rejat, as nipat, as mbesat. Vëllezërit, jo se jo. Me të ishin bërë bashkë në kampin e Bllacës djemtë e të vëllait, Kujtimi e Arbeni, ata kujdeseshin për të. Baca Sejdi pinte duhan tërë kohën, tundte kokën dhe mezi nxirrte zë. Aty kam takuar edhe motrën time të dashur, dadën Fatë, me djemtë e me rejat, me nipat e me mbesat, nën qiellin e hapur, disa ditë pa ngrënë e pa pirë asgjë. Edhe në atë vuajtje ajo u përpoq të kujdesej për mua, më dha pak qumësht që u ishte gjetur dhe deshi të ma jepte xhemperin që e kishte të veshur, sipas saj që të mos ftohesha. Kampi i Bllacës ka qenë një kamp përqendrimi fashist, ku njerëzit i janë ekspozuar vuajtjes dhe vdekjes. Unë i përmbahem kësaj formule. Përveç në dramën "Bryma e vdekjes", vuajtjen në atë kamp e kam përshkruar edhe në një cikël poezish me titull "Poezia e Bllacës" në vëllimin "Rigjetja e vetes".

Në poezinë *"Faltorja e munguar"* jam munduar ta zbërthej e ta plasoj se degradimi, ikja nga besimi kanë qenë shkaqet që na e sollën atë katandisje:

## FALTORJA E MUNGUAR

Tash që kanë kaluar kaq vite
Më vjen turp ta mendoj
Si s'u kujtova vetë
Po si s'u kujtua askush
Që të ngrehnim një faltore
E të luteshim me zemër
Me ballë përdhe
Në baltën e Bllacës
Zoti të na i falte mëkatet tona të mëdha
Që na kishin sjellë në atë vend
Ku po e humbnim kuptimin
E po bëheshim vetëm hije lebetitëse
Të një jete të shkatërruar
Edhe me duart tona
Si more as mua s'm'u kujtua?

Ndërsa në poezinë *"Kur vinte buka"* e kam evokuar idenë se si hakërrohej masa për bukë, duke u shndërruar në një masë agresive, të rebeluar, një asociacion me përvojën e Musait me popullin e tij të rebeluar derisa ai ishte në takim në Zotin:

Oh
Kur vinte buka
Masa e kotur zgjohej e egërsuar
Si në filmat e Ajzenshtajnit
Dhe lëvizte në rreth
E askush s'mund t'i kapte bukët që fluturonin
Sepse secili e pengonte secilin

Kërkonin t'u jepej diçka tjetër
E prandaj ulërinin, silleshin në rreth
Shanin mallkonin
E shkelnin mbi bukët që kishin rënë përtokë
Këta njerëz nuk po mësonin asgjë
Nga përvoja e popullit të Musait
As në atë siklet, o medet!
Veç viçi që t'i faleshin, po u mungonte

Pas pesë ditësh në atë kamp erdhi urdhri që gratë dhe fëmijët mund të dilnin, ndërsa burrat jo. Mezi e binda Diben që t'i merrte dy vajzat tona, Teutën dhe Bubulinën, e të dilte. Kur u larguan drejt autobusit, unë u lehtësova. Për mua me rëndësi ishte që ato të shpëtonin nga ajo vuajtje, sepse për veten më as që po mendoja. Por, pas disa minutash, ato u kthyen dhe nuk donin të shkonin pa mua. Më duket se Bubulina kishte bërë më se shumti luftë që të mos shkonin pa mua. Mezi i binda, duke i marrë me të mirë, duke i lutur dhe disi u nisën. Mbeta krejt vetëm në atë masë njerëzish të hutuar, të dërrmuar, të thyer, të shkatërruar. Shkova në një kënd dhe rashë e fjeta, pas pesë ditësh që vetëm kisha dremitur ulur ose edhe në këmbë. Kur u zgjova, turma e burrave (burra u thënçin) ishte alarmuar, ishte shndërruar në një masë të tmerruar, lebetitëse, nuk e di çfarë. Dikush kishte përhapur fjalë se policia serbe na kishte rrethuar dhe se do të na vrisnin të gjithëve. Po mundohesha të qetësoja disa që kisha afër, por aty e kam parë me sytë e mi se si njerëzit, kur i kapë frika e madhe, thjesht u paralizohet edhe mendimi logjik. Kur e pashë se ajo histeri nuk mund të ndalohej, u shkëputa prej asaj mase, zbrita në luginë, ku e kalova natën me bacën Sejdi, me Kujtimin e me Arbenin.

Të nesërmen herët, në orën pesë të mëngjesit, me ndihmën e Kujtimit që ishte angazhuar në Kryqin e Kuq, dola disi nga kampi. Tek po dilja i pashë Muharrem Qenën dhe Igballen se si po mundoheshin të dilnin, po Muharremi dukej i sëmurë dhe e kishin një valixhe të madhe me vete. U afrova dhe ia mora Igballes valixhen, e kapa Muharremin në njërën anë e Igballja në tjetrën dhe, ashtu dolën edhe ata. U futëm në një autobus dhe u nisëm për në Tetovë. Igballja u shkreh në vaj, sepse në kamp kishin mbetur fëmijët e tyre.

Kur arrita në Tetovë e gjeta disi Memlin, pastaj me të shkova në familjen ku ishin strehuar Edibja me vajzat. Familja e Burhan Xhaferit ishte një familje e vogël dhe realiste e varfër, por ata ishin njerëz të mirë e me zemër të madhe. Na strehuan e na ndihmuan si të na kishin anëtarë të familjes së vet. Ne u jemi mirënjohës gjithmonë atyre njerëzve të mirë.

**(Marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Ky shkrim është në librin e po të njëjtit autor, me titull "Sekretet që nuk i mori me vete Ibrahim Rugova", botuar në vitin e kaluar)**

# Shkolla 'Hasan Prishtina' në Tërpezë shënon 70-vjetorin e themelimit



Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi ka marrë pjesë në ceremoninë festive të 70 vjetorit të themelimit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Hasan Prishtina" në Tërpezë të Malishevës.

Fillimisht, ministri Bytyqi është pritur nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe udhëheqës tjerë të qeverisjes lokale , me të cilët bisedoi për arsimin në këtë komunë, të arriturat dhe vështirësitë.

Ndërsa, në ceremoninë e 70 vjetorit të shkollës "Hasan Prishtina", ministri Bytyqi, me këtë rast, ua uroi nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe gjithë komunitetit këtë ditë dhe theksoi se kjo shkollë me kaq shumë vite punë dhe me një emër të madh, vazhdimisht ka qenë një vatër e edukimit të të rinjve, një vatër që ka nxjerrë kuadro që më vonë kanë kontribuar në shumë aspekte të zhvillimit.

"Kjo shkollë, mësimdhënësit tanë, kanë bërë një sakrificë të jashtëzakonshme në mënyrë që sot të jemi këtu dhe kanë kontribuar që shkolla sot, në këtë 70 vjetor të themelimit, të jetë krejt ndryshe, që Tërpeza sot ta festojë krejt ndryshe ditën e shkollës. Kjo na bën krenarë, na e lehtëson punën dhe na shton përgjegjësinë për të vazhduar më tutje", tha ministri Bytyqi në shkollën ku edhe ai vet i ka vijuar mësimet si nxënës.



Ministri theksoi se ajo sakrificë e mësimdhënësve tanë, pa e përjashtuar edhe angazhimin e prindërve dhe nxënësve, ka bërë që sot të jemi në një formë të re të edukimit të brezave të rinj për një të ardhme të re.

Ministri Bytyqi tha se vendi ynë ka nevojë për energji të reja, për dije të re, pra ka nevojë për një rini të edukuar mirë dhe të shëndetshme. Prandaj kërkoi nga nxënësit që ta bëjnë maksimumin, që të marrin dije në këtë shkollë dhe ta shfrytëzojnë këtë dije edhe për zhvillimin e vendit tonë.

Ndërsa, mësimdhënësit i porositi që të vazhdojnë t'i edukojnë sa më mirë të rinjtë. "Profesioni juaj është edhe profesion fisnik dhe siguroni karrierë dhe të ardhme për të rinjtë, e në këtë mënyrë siguroni të ardhmen edhe të vendit", tha Ministri.

Ministri Bytyqi siguroi udhëheqësit e shkollës dhe të Komunës, se MAShT do të jetë vazhdimisht afër tyre që të sigurojë kushte sa më të mira për nxënësit dhe mësimdhënësit.











## Izraeli sulmon Rripin e Gazës

TEL-AVIVI, 29 MAJ - Avionët ushtarakë izraelitë kryen të martën sulme ajrore në Rripin e Gazës, me objektiv pozicionet e grupit militant Xhihadi Islamik.
Sulmet ndodhën disa orë pasi Forcat Mbrojtëse të Izraelit njoftuan se militantët në Gaza hodhën të paktën 25 mortaja në drejtim të Izraelit Jugor.
Në deklaratën izraelite thuhej se shumica e predhave u interceptuan nga sistemi i mbrojtjes raketore. Disa prej tyre ranë në zona të hapura. Nuk ka pasur njoftime për dëmtime.
Gjatë dy muajve të fundit tensionet përgjatë kufirit kanë qenë të larta. Palestinezët protestojnë duke bërë thirrje që t'u garantohet e drejta për t'u kthyer në tokën nga e cila u larguan me forcë gjatë periudhës së krijimit të shtetit të Izraelit në 1948. Ata protestojnë gjithashtu kundër bllokadës që është në fuqi ndaj Gazës prej më shumë se një dekade si dhe ndaj zhvendosjes së Ambasadës amerikane nga Tel-Avivi në Jerusalem.
Që nga fundi i muajit mars forcat izraelite kanë vrarë të paktën 115 palestinezë, duke nxitur kritika për përdorim të tepruar force. Izraeli ka fajësuar grupin militant të Hamasit për nxitje të dhunës dhe thotë se ka vepruar për të mbrojtur kufirin.



# Vazhdojnë negociatat për një takim të mundshëm Trump - Kim

Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë të martën se kemi ngritur një ekip shumë të mirë për bisedimet me Korenë e Veriut dhe aktualisht po flitet për takimin e nivelit të lartë dhe çështje të tjera



UASHINGTON, 29 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump konfirmoi se një zyrtar i lartë koreano-verior është për vizitë në Nju Jork për bisedime që lidhen me një takim të nivelit të lartë në mes të Trumpit dhe udhëheqësit koreano-verior Kim Jong Un.
Trumpi e bëri njoftimin në "Twitter", ndërsa vazhdojnë negociatat për një takim të mundshëm mes presidentit amerikan dhe udhëheqësit koreano-verior. "Kim Young Chol, zëvendëskryetar i Koresë së Veriut, është nisur për në Nju Jork", shkruante presidenti Trump në "Twitter".
Javën e kaluar Trumpi i dërgoi një letër Kim Jong Unit, ku thoshte se takimi i planifikuar për 12 qershor nuk do të mbahej për shkak të "zemërimit të madh dhe armiqësisë së hapur", që ishte shprehur në një deklaratë të udhëheqësit koreano-verior.
Por negociatat mes dy vendeve kanë vazhduar, mes të cilave bisedime të dielën në zonën e çmilitarizuar koreane. "Kemi ngritur një ekip shumë të mirë për bisedimet me Korenë e Veriut. Aktualisht po flitet për takimin e nivelit të lartë dhe çështje të tjera", tha Trumpi të martën.
Zëvendësshefi i personelit i Shtëpisë së Bardhë, Joe Hagin dhe të tjerë nga administrata e Trumpit, shkuan të dielën në Singapor, vendi ku mendohet të mbahet takimi. "Ata udhëtuan në Singapor për t'u marrë me përgatitjet logjistike", konfirmoi një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë për "Zërin e Amerikës" të hënën.
Para takimit Trump-Kim, presidenti amerikan ka në plan të mbajë bisedime me kryeministrin japonez Shinzo Abe. "Ramë dakord të takoheshim para takimit të nivelit të lartë ShBA - Koreja e Veriut", tha Abe në Tokio pas një telefonate të hënën me Trumpin.
Presidenti Trump dhe kryeministri Abe "konfirmuan gjithashtu domosdoshmërinë e realizimit të çmontimit të plotë dhe të përhershëm të armëve bërthamore, kimike dhe biologjike të Koresë së Veriut dhe programeve të raketave balistike", sipas një deklarate të Shtëpisë së Bardhë.
Nuk është e qartë se kur ose ku do të takohen presidenti Trump dhe kryeministri Abe para takimit të Singaporit.
Edhe presidenti i Koresë së Jugut, Moon Joain mund të shkojë në Singapor muajin e ardhshëm për një takim trepalësh me homologët e tij të Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut, tha një zyrtar i qeverisë në Seul të hënën.
Pas një takimi të papritur të shtunën mes Kimit dhe Moon Jae-init, presidenti koreano-jugor tha se udhëheqësi koreano-verior vazhdon të jetë i angazhuar për një gadishull korean pa armë bërthamore.

# Peskov: Hetimet e Muellerit për Rusinë janë të pabaza

MOSKË, 29 MAJ - Kremlini ka thënë të martën se hetimet e këshilltarit special, Robert Mueller, për ndërhyrjen e supozuar ruse në zgjedhjet amerikane më 2016 janë të pabaza, transmeton "Reuters". "Kemi shpresë se e gjitha do të përfundojë një ditë", është shprehur zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov kur është pyetur për këtë çështje. "Ujë që kalon përmes një site, kështu i themi



ne në rusisht", ka thënë Peskov për hetimet amerikane, duke pretenduar se të njëjtat janë të pabaza.
"Kjo është pikërisht si po duket procesi tani", tha ai.
Rusia ka mohuar vazhdimisht pretendimet se ka ndërhyrë në zgjedhjet amerikane për t'i ndihmuar presidentit aktual Donlad Trump për ta fituar Presidencën, duke thënë se ShBA-ja ka orkestruar një fushatë anti-ruse.

## Tre të vdekur nga sulmi në Belgjikë

AMSTERDAM, 29 MAJ - Një sulmues me armë zjarri ka vrarë dy zyrtarë policorë dhe një kalimtar në qytetin Liege në lindje të Belgjikës.
Zyrtarët kanë thënë se sulmuesi është larguar nga skena e sulmit, i cili ka ndodhur në qendër të qytetit më 29 maj.
Dy zyrtarë të tjerë policorë janë raportuar të plagosur në incident.
Sulmuesi i dyshuar ka marrë peng një mirëmbajtëse afër shkollës, mirëpo më vonë ai është qëlluar për vdekje, ka njoftuar transmetuesi shtetëror, RTBF. Sipas televizionit, sulmuesi ka qenë një kriminel 36-vjeçar, që ishte liruar nga burgu të hënën.
Hetuesit kanë thënë se janë duke kërkuar nëse ai ishte konvertuar në fenë Islame apo ishte radikalizuar gjatë kohës sa ishte në burg, transmeton "Reuters". "Ky incident është klasifikuar si akt terrorist", ka thënë prokurori, Philippe Dulieu.
Gazeta belge, "La Libre Belgique" ka cituar një burim nga policia të ketë thënë se sulmuesi ka bërtitur "Allahu Akbar" (Zoti është më i madhi).
Kryeministri belg Charles Michel u ka shprehur ngushëllime familjeve të viktimave duke thënë se është shumë herët për të deklaruar se cilat ishin shkaqet e incidentit. Policia belge dhe ushtria kanë qenë të alarmuar prej kur disa sulmues me bomba vetëvrasëse kanë vrarë 32 persona në aeroportin e Brukselit dhe sistemit e metrosë më 2016. Për këto sulme e kishte marrë përgjegjësinë grupi militant, Shteti Islamik.



E jashtëzakonshme

# Katërvjeçari ngecën në lavatriçe



Një djalë i vogël është nxjerrë nga një makinë larëse nga një grup zjarrfikësish. Ngjarja ndodhi në qytetin Zibo në Kinë. Zyrtarët thonë se djali u ngjit në makinë dhe mbeti i bllokuar. Zjarrfikësit sharruan makinën për më shumë se 20 minuta për të provuar ta lirojnë atë. Më në fund, e thyen makinën dhe e shpëtuan djalin.

FOTO E DITES



Një burrë shihet me qentë e tij duke kryer një ushtrim në Gjermani. /AP/

E rrallë

# Lind foshnja me lëkurën që duket si plastikë



Një çift indian ka shkuar në tre spitale kur djali i tyre erdhi në jetë me një gjendje të rrallë që e bën lëkurën e tij të duket si plastikë. Një ekspert ka thënë se gjendja e lëkurës është jashtëzakonisht e rrallë dhe foshnja po mbahet në jetë me aparatura.

## BARSOLETA E DITËS



**Polici shkon ta marrë fëmijën në çerdhe, edukatorja e pyet:**
**- Zotni, cili është fëmija juaj?**
**- Ma jep cilindo, se nesër jua kthej në mëngjes.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

## "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo







**Në ora 18:00**

## "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

## "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

## "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nëse kohët e fundit nuk mund të bënit dot lëshime ndaj partnerit tuaj, sot mund ta bëni një gjë të tillë.



**DEMI**
Marrëdhënia me partnerin do të mbështetet tek bashkëpunimi dhe harmonia. Së bashku do të merrni vendime mjaft të rëndësishme.



**BINJAKËT**
Me çdo kusht do të kërkoni ta detyroni atë që keni në krah të pranojë ato që thoni ju dhe do të jeni të pabindur. Vetëm nga mbrëmja dialogu mund të rilindë dhe të jeni më të qetë.



**GAFORRJA**
Jeta sentimentale e çifteve do të jetë e mbrojtur. Do t'i falni shumë dashuri e ngrohtësi partnerit dhe ai do të ndihet rehat pranë jush.



**LUANI**
Përveçse do të flisni për çdo gjë me partnerin tuaj sot, do të kaloni edhe momente shumë sensuale. Kujdes mos bëni skena xhelozie, sepse ai nuk e meriton.



**VIRGJËRESHA**
Klima yjore gjatë kësaj dite do të jetë në përgjithësi e ngrohtë dhe do t'ju ndihmojë ta përmirësoni jetën në çift. Merrni masa sa më parë që të mos ngeleni keq në fund.



**PESHORJA**
Jo të gjitha ditët ju bëni çmos ta gjeni ekuilibrin ndërmjet karrierës dhe jetës në çift. Në planin financiar ka ardhur momenti të ndërmerrni iniciativa. Priten surpriza të mira.



**AKREPI**
Nëse hasni vështirësi në jetën tuaj në çift, mundohuni t'i rregulloni sa më parë ato. Me financat do të keni fat. Mund edhe të guxoni të bëni ndonjë investim më të madh.



**SHIGJETARI**
Nëse tregoheni më realistë do të përjetoni edhe më tepër kënaqësi. Financat nuk do të të jenë të këqija, por shmangni marrjen e rreziqeve të mëdha që të jeni më të sigurt.



**BRICJAPI**
Ka rrezik të keni mosmarrëveshje me partnerin tuaj sot. Nuk do t'ju pëlqejë aspak sjellja e tij kohët e fundit dhe do të kishit preferuar që ai të tregohej më i hapur me ju.



**UJORI**
Do të kaloni një ditë të bukur në çift. Kujdesuni më shumë për partneren tuaj. Lëni anash pak shoqërinë dhe përkushtojeni familjes së ngushtë.



**PESHQIT**
Dita e sotme do të jetë e mbushur me ndjenja dhe emocione të forta. Do të kuptoheni më mirë me atë që dashuroni dhe do të bëni gjithçka që ju pëlqen të dyve.

# A po martohet Jeremy Meeks?



Gjërat po bëhen serioze në mes të Jeremy Meeksit dhe Chloe Greenit. Burime të afërta me çiftin thonë se ai po planifikon t'i propozojë të dashurës martesë. "Chloe dhe Jeremy janë shumë të dashuruar dhe ajo mendon se ai së shpejti do t'i propozojë. Chloe nuk do të bënte fëmijë me Jeremyn derisa nuk janë të martuar", ka thënë burimi për "USmagazine".

# Drake publikon këngën e re



Drake ka publikuar këngën e re me titull "I'm Upset" për të cilën thotë se është pjesë e albumit të tij të ardhshëm "Scorpion". "Kënga e re ka dalë tashmë", ka shkruar Drake në rrjetin social në "Instagram".




# Aktorja e famshme kaloi tri ditë pa i larë dhëmbët

Aktorja e famshme Kelly Brook ka zbuluar se i dashuri i saj Jeremy Parisi e ka kritikuar atë shumë herë pasi ajo ka ngrënë shumë ëmbëlsirë. Gjatë një interviste për "Loose Women", 38-vjeçari zbuloi se e dashura e tij ka kaluar tri ditë pa i larë dhëmbët.

# Emma Watsoni ndahet nga i dashuri



Emma Watsoni dhe Chord Overstreet thuhet se janë ndarë pas gjashtë muajsh në lidhje. Aktorja 28-vjeçare dhe aktori 29-vjeçar i dhanë fund marrëdhënies, sipas "The Sun". "Emma dhe Chord qëndruan të qetë në lidhje me marrëdhënien e tyre në fillim, por ata me të vërtetë u ndanë. Ata kaluan shumë kohë së bashku në Los Angeles dhe u fotografuan mjaft pak para disa muajsh", ka thënë një burim.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | AUSTRIA - RUSSIA | GG | PERU - SCOTLAND | 1 | PANAMA - NORTHERN IRELAND | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Gashi: Vëllaznimi ishte i pafat

Kushtrim Gashi është i dëshpëruar që skuadra e Vëllaznimit i humbi dy ndeshjet kryesore në penallti. Ai për "Epokën e re" ka thënë se kuqezinjtë ishin të pafat në edicionin 2017/2018. "Vëllaznimi ka qenë skuadër e pafat në dy ndeshje vendimtare: finalen e Kupës dhe në ndeshjen e barazhit. Në finale ndaj Prishtinës e kemi merituar të fitojmë në bazë të asaj që kemi treguar në fushë, por penalltitë janë fat dhe aty ne dështuam, sikurse që dështuam ndaj Ferizajt", ka thënë ai

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 MAJ - Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova humbi dy ndeshjet më të rëndësishme për edicionin 2017/2018 në penallti. Kjo i kushtoi skuadrës gjakovare me rënien në Ligën e Parë të Kosovës në Futboll.

Mesfushori Kushtrim Gashi, i cili ishte ndër lojtarët më të mirë për skuadrën kuqezi gjatë gjithë edicionit, ka thënë se Vëllaznimi ka qenë skuadër e pafat dhe se nuk e ka merituar rënien nga Vala Superliga, pasi numri i pikëve të grumbulluara në edicionin e rregullit ishte mjaft i madh. "Vëllaznimi ka qenë skuadër e pafat në dy ndeshje vendimtare: finalen e Kupës dhe në ndeshjen e barazhit. Në finale ndaj Prishtinës e kemi merituar të fitojmë në bazë të asaj që kemi treguar në fushë, por penalltitë janë fat dhe aty ne dështuam, sikurse që dështuam ndaj Ferizajt. Më 44 pikë të largohesh nga Superliga për ne futbollistët është tepër e rëndë. Vëllaznimi në shumicën e kohës ka qenë në hap me top ekipet e Superligës dhe kur në fund nuk e arrin ekzistencën, është dëshpëruese", ka thënë Gashi për "Epokën e re".

Futbollisti i talentuar pas formës së mirë që ka treguar, ka marrë edhe disa oferta nga klubet e Superligës, por ai vazhdon të jetë i pavendosur për të ardhmen. "Oferta kam nga disa klube, por ende nuk kam vendosur asgjë. Tash për tash nuk mund të them se do të qëndroj apo të largohem nga Vëllaznimi. Shumë shpejt do të marr një vendim për të ardhmen time", ka deklaruar Gashi.

Skuadra kuqezi pritet që shumicën nga lojtarët kryesorë t'i mbajë, pasi synim kryesor në edicionin e ri të futbollit do ta ketë rikthimin në Vala Superligën e Kosovës në futboll.



## Prishtina rikthen Thaqin, pritet transferimi i Bekteshit dhe Rexhës

Skuadra e Prishtinës është duke punuar maksimalisht për transferimin e futbollistëve për edicionin e ri të futbollit. Një ditë pasi e transferoi Ahmet Halitin, skuadra "bardhekaltër" ka arritur marrëveshje edhe me Armend Thaqin e Gjilanit. Gazeta ka mësuar se bisedimet janë duke u zhvilluar edhe me mbrojtësin Leotrim Bekteshi dhe sulmuesin Kastriot Rexha.

SHKURT

### Kërkesë e çuditshme e Shevchenkos për miqësoren ndaj Shqipërisë

Shqipëria, pas Kosovës, do të luajë miqësore edhe me Ukrainën që drejtohet nga Andriy Shevchenko. Ndeshja ishte parashikuar të luhej në stadiumin e Evian në Francë më 3 qershor, por Shevchenko ka kërkuar së fundmi të ndryshohet stadiumi. Kërkesa e tij ka shkuar deri në FIFA dhe tashmë po diskutohet me organizatorët e të dyja palëve, por ende nuk ka një vendim. Kërkesa mund të vlerësohet si e çuditshme, pasi shqetësimi i trajnerit të Ukrainës nuk është terreni, i cili është në kushte mjaft të mira, por kapaciteti i stadiumit.

### Javë vendimtare për Neuerin

Berlin, 29 maj - Nëse skuadra bëri një ditë e gjysmë pushim në fundjavë, Manuel Neueri preferoi të bënte një tur me biçikletë në Tirol, ku natyra dhe relievi i dhanë mundësi të shijonte një ministërvitje. Kjo është një javë vendimtare për portierin gjerman. Trajneri Joachim Low deklaroi para disa ditësh se portieri do të udhëtojë me skuadrën vetëm nëse rikuperohet plotësisht dhe të jetë gati të luajë si numri 1. Në program janë ndeshjet miqësore me U-20, aty do të shihet edhe forma aktuale e portierit në lojë. Gjatë stërvitjes ai ka shfaqur një dëshirë të madhe për t'u rikthyer, ai kërkon me çdo kusht të udhëtojë në Rusi për ta mbrojtur portën e kombëtares gjermane.

### Fabinho: Ishte e lehtë t'i thuash 'po' Liverpoolit

Mesfushori Fabinho ka deklaruar se transferimi te Liverpooli ishte vendim i marrë shumë lehtë. Braziliani ka thënë se para transferimit ka folur me shokun e tij Roberto Firmino dhe menaxherin Jurgen Klopp. Këto biseda e kanë bindur 24-vjeçarin të kalojë në Angli. "Fola në telefon me Firminon. E njoh personalisht dhe kam qenë në kombëtare me të. Pata mundësi të flisja me trajnerin dhe njerëzit që punojnë në klub. Më dhanë shumë besim, treguan se më dëshirojnë. Kur u takuam çdo gjë shkoi mirë. Doja të shkoja te një klub që më donte, që shfaqi interesim të madh. Me këto, ishte e lehtë t'i thosha po", ka thënë Fabinho.

## Batatina heq dorë nga posti i trajnerit



BESIANË, 29 MAJ - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, është duke menduar ta lë postin e trajnerit në skuadrën e Llapit. Megjithatë, ai ka bërë me dije për "Gazetën Sheshi" se sërish do të jetë pjesë e klubit, kurse do ta kryejë detyrën e drejtorit sportiv. "Po mendoj ta organizoj skuadrën duke kaluar si drejtor sportiv. Në këtë mënyrë dua të pushoj pak dhe po e shikoj mundësinë që ta vijoj kursin për licencën 'Profi'. Po ashtu, këtë vit të bëj një super-organizim në klub, vetëm kështu do të kem kohë më shumë. E kam parë që nuk kishim organizim të mirë në dy vjetët e fundit. Ishim afër trofeve, por nuk ia dolëm. Nuk dua që edhe ky vit të na shkojë kështu, andaj gjërat do t'i marrim seriozisht", ka thënë Batatina.

## Titulli në konkurrencën e femrave vendoset të enjten



Prishtinë, 29 maj - Ndeshja përcaktuese për titullin e kampionit në Superligën e femrave ndërmjet Hajvalisë dhe Mitrovicës do të zhvillohet të enjten, më 31 maj, në orën 16:30, në stadiumin "Shahin Haxhiislami" në Pejë. Kjo ndeshje, përveçse do ta japë emrin e kampionit të Kosovës, njëherësh do të vendosë edhe për skuadrën e cila do ta përfaqësojë Kosovën në Ligën e Kampionëve. Këto dy skuadra u takuan në fundjavën që e lamë pas edhe në finale të Kupës së Kosovës ku, pas një loje mjaft interesante, triumfuan vashat e Mitrovicës, 2:1.

# Dybala: Argjentina e fiton Botërorin sepse e ka Messin



Buenos Aires, 29 maj - Lojtari i Juventusit, Paulo Dybala, hyri falë talentit në listën e Sampaolit. Nëse nuk do të ishte nuk do të quhej mungesa e madhe e Argjentinës. Në miqësoret e fundit në Evropë ai nuk ishte thirrur dhe ato ditë ndodhej më shumë jashtë se brenda kombëtares. Por, nuk kishte padrejtësi dhe ai stërvitet me kombëtaren e vendit të tij për Botërorin e Rusisë. Ai foli përsëri, me kujdes, pas deklaratave të diskutueshme në lidhje me pajtueshmërinë e tij me Messin, që e vendosin lojtarin e Juves në buzët e të gjithëve. "Trajnimi me të dhe mundësia për ta parë Messin çdo ditë është diçka e pabesueshme, sepse mësoni shumë nga cilësitë që ka. Të jesh kampion botëror është dëshira e të gjithëve. Nuk do të jetë e lehtë, por ne kemi lojtarin më të mirë në historinë e futbollit dhe do të bëjmë gjithçka të mundur për ta arritur atë", ka thënë Dybala. "Dëshira për ta ndihmuar Leon, që të arrijë një objektiv të tillë, është e madhe. Do të ishte diçka e mrekullueshme për të gjithë fitimi i Botërorit, diçka shumë e madhe. Ne përpiqemi ta ndihmojmë atë nga vendi ku luajmë. Duke pasur lojtarin më të mirë në historinë e futbollit në kombëtaren tënde, ëndrra është shumë e madhe. Ëndrra e të gjithëve është të shpallemi kampionë botërorë", ka shtuar Dybala.

# Për herë të katërt finalja Golden State - Cleveland




Ohio, 29 maj - Golden State Warriors dhe Cleveland Cavaliers do të shkruajnë një tjetër kapitull për sa i përket historisë së finaleve të NBA-s. Për të katërtin vit radhazi të dyja këto skuadra do ta diskutojnë çështjen e titullit kampion në ligën më madhështore të basketbollit në botë. Nëse në Lindje Clevelandi konfirmoi dominimin e tij, në Konferencën e Perëndimit ishte Golden State që e bëri këtë duke fituar edhe ndeshjen e shtatë, atë më vendimtare të përballjeve me Houston Rocketsin. Në "Toyota Center" skuadra kaliforniane fitoi ndaj asaj teksane me rezultatin 101-92. Houstoni e mbylli periodën e parë me avantazhin e 5 pikëve 24-19, ndërsa në pushimin e ndeshjes arriti me avantazhin 54-43. Kjo nuk mjaftoi sepse me rikthimin në parket për dy periodat e tjera, Golden State shpërtheu duke e mbyllur 12-minutëshin e tretë me rezultatin e frikshëm 33-15 për ta kthyer përfundimisht situatën në favor duke u shpallur kampion i Konferencës së Perëndimit që i dha edhe biletën e finales së madhe ku Warriorsi do të kërkojë ta mbrojë titullin e fituar vitin e kaluar. Për Golden State protagonistë u bënë katër lojtarë, Duranti me 34 pikë, Curry me 27 pikë e 10 asistime, Klay Thompsoni me 19 pikë e Greeni me 10 pikë e 13 topa në tabelë. Për Rocketsin nuk mjaftuan 32 pikët e James Hardenit, 23 të Eric Gordonit e 20 pikët e Clint Capelës për ta mposhtur Golden Staten. Ndeshja e parë e finales së Madhe të NBA-së në mes të Clevelandit e Golden States do të luhet në mbrëmjen e së enjtes në "Oracle Arena" në Oakland të Kalifornisë.

## SHKURT

### Nesër fillon gara ndërkombëtare në çiklizëm

Më 31 maj fillon edicioni i garës ndërkombëtare në çiklizëm "Rrethi Çiklistik i Kosovës - 2018". Pjesëmarrjen në këtë ngjare sportive, përveç Kosovës, e kanë konfirmuar edhe një ekip nga Holanda, dy ekipe nga Bullgaria, dy ekipe nga Maqedonia, dy ekipe nga Shqipëria dhe një ekip nga Mali i Zi. Etapa e parë fillon më 31 maj nga Sheshi "Nënë Tereza" në Prishtinë në orën 10:00.
Etapa 1: Prishtinë-Mramor-Llukar-Kamenicë-Gjilan-Ferizaj 115 km. Starti: ora 10:00. Sheshi "Nëna Terezë", Prishtinë.
Etapa 2: Ferizaj-Shtime-Komoran-Skenderaj-Rakosh-Gurakoc-Klinë-Gjakovë 140 km. Starti: ora 10:00 para Palestrës Sportive - Ferizaj.
Etapa 3: Gjakovë-Mrasor-Gllarevë-Kijevë-Malishevë-Duhle-Suharekë-Samadrazh-Optorush-Rahovec-Brestovc-Hoqë-Krushe e Madhe-Piranë-Landovicë 115 km. Starti: ora 10:00 para Hotel "Pashtriku" - Gjakovë.
Etapa 4: Prizren-Prevallë-Brezovicë-Fushë-Pajtim-Kaçaniku i Vjetër-Viti-Gjilan-Bresalc-Livoq-Slivovë-Mramor - 130 km . Starti: ora 10:00 në Sheshin "Shadërvan" në Prizren.

### Kryeziu, afër largimit nga Luzerni

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës, Hekuran Kryeziu, nuk ka pranuar ta rinovojë kontratën me Luzernin. Futbollisti 25-vjeçar është pjesë e Luzernit që nga viti 2004. Debutimin në ekipin e parë e bëri në sezonin 2010. Ai është larguar nga Luzerni vetëm për një periudhë të shkurtër, në Vaduz, por u kthye shpejt për t'u bërë lojtar kyç në ekip. Kryeziu obligohej të nënshkruante kontratë të re me Luzernin nëse do të kishte arritur një numër të caktuar të ndeshjeve. Por, ky numër nuk u arrit dhe Kryeziu është i lirë të vendosë për të ardhmen e tij. "Klubi nuk ka qenë në gjendje të bjerë dakord për një kontratë të re, pavarësisht se pati bisedime të gjata dhe intensive. Luzerni dëshiron ta falënderojë Hekuran Kryeziun për përkushtimin dhe i dëshiron gjitha të mirat në të ardhmen", thuhet në njoftimin e klubit zviceran.
Për Kryeziun interesim ka shprehur Zuerichu, St. Galleni, Lazio dhe Atalanta.

### Unitedi heq dorë nga Bale

Pas performancës fantastike në finale të Ligës së Kampionëve, të cilën Real Madridi e fitoi falë 2 golave të Gareth Bale kundër Liverpoolit, Florentino Perez tani i kërkon 229 milionë euro për ta lëshuar uellsianin. Përveç çmimit të lartë të transferimit të tij, Unitedit do t'i duhej t'i paguajë plot 155 milionë euro të tjera në llogarinë bankare të Bales për pagat e tij vjetore për katër vjet kontratë. Këto shifra të larta e kanë bërë gjigantin anglez të dyshojë seriozisht se a ia vlen ta transferojë për një shumë të tillë një lojtar që në të kaluarën ka vuajtur nga lëndime të shumta.

### Liverpooli e dëshiron Stakoshën në vend të Kariusit

Loris Karius është pothuajse i larguar pas gafave në finalen e Ligës së Kampionëve. Liverpooli është vënë menjëherë në lëvizje për një portier tjetër. Ata kanë besim te gardiani i kombëtares shqiptare, Thomas Strakosha. Siç raporton nga Italia "Il Messaggero", ata kanë gati një ofertë prej 30 milionë eurosh për shërbimet e shqiptarit. Tare dhe Lotito janë vënë menjëherë në lëvizje. Liverpooli ka kohë që po kërkon shërbimet e një portieri dhe pista Donnarumma apo Alison duket se janë larg. Tare nuk ka ndenjur duarkryq, por ka kërkuar informacion për Iker Casillasin, që luan me Porton në Portugali. Sipas raportimeve, spanjolli është i gatshëm të vijë edhe si portier i dytë në Romë.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | QË ZHVILLOHET ME FORCË E SHPEJT | E KËPUTUR; E MPAKUR | VERBAND OSTBELGIS. RADSPORTLER | MUZIKANTI YNË NË FOTO .... BAJRI | KOMIKU I SHQUAR ... CARREY (origj.) | I GJYMTOVA | TRAJNERI ISMET ...... (LLAMKOS KOSOVA) | EPOKA E RE | ZANORE | QËLLIM I PARAMEN-DUAR, PARAMENDIM | NUMËR THEMELOR |
| | | | | | | SHMANGIE | | | | | | | | VEPËR E KRYER, PUNË / SHKRIMTARI GJERMAN ERIK MARIA | | | |
| | | | | | | SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR | | | | | | | | | DUKAT | | |
| | | | | | | SHKRIMTARJA KAMBERI | | | | | | | | | SELEN / KALIBRI I TYTËS SË ARMËS | | |
| | | | | | | ADRIAN KRASNIQI | | | BASHKËT. / FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO | | VLERË, DOBI (krah.) / BASHKËT. | | | | | | DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME |
| | | | | | | AKTORJA E FAMSHME DEMI ... (shqip.) | | | | GOCAT / TITAN, LITËR | | | | | | BASHKËT. / PJESË ERRËT E DITËS | |
| | | | | | | PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (vjet.) | | | | | DESPOTI / PAJISJE PËR DREJTIMIN E VETURËS | | | | | | |
| | | | | | | KRUJA | | RYSHFET / ELEMENT KIMIK | | | | | GRUP MAFIOZ / I KËTIJ ÇASTI, I KËSAJ KOHE | | | | |
| EPOKA E RE | KEQTINGË-LLIM | TË FIKËT | NDËRTESË E POSAÇME KU SHFAQEN FILMA | POLITIKANI FERID | EPOKA E RE | PËREMËR VETOR | SHTET NË AMERIKË (pashq.) / BLETA QË IKËN NGA ZGJOI I VET | | | | | | | TRAJNERI GJERMAN REHAGEL | | | |
| FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN LEITE .... | | | | | LAJ NË AR, PRAROJ / ZANORE | | | | | KRAHINË NË SHQIPËRI / PRESIDENTI AMERIKAN ..... OBAMA | | | | FAMË / BAKRI | | | |
| LLOJ KROKODILI | | | | | | | | | BEDRI OSMANI / BURNT ORANGE REPORT | | | FLORIRI / GRUMBULLIM | | | | SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA | FEMRA E KALIT (sh.shq.) |
| SHTET I MADH NË AZI | | | | | ADEM JASHARI | | | BIMË E VENDEVE TË NXEHTA / BASHKËT. | | | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / EMPOLI | | |
| ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL (LIVERPOOL) | | | | | DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË | GAZ PËR DEZINFEKTI-MIN E UJIT / RILINDËSI .... VRETO | | | | | EMËR YNI FEMRE / VETURAT, AUTOMJETET | | | | | | |
| NJËSI E VOGËL E ORGANIZIMIT TË JETËS SHOQËRORE | | | | | | | | POLITIKANI HARADINAJ (shq.) / BERAT LUZHA | | | | | | | ANNA LEE / TOKA E BUKËS | | |
| OKSIGJEN, NATRIUM | | | | SHKRONJA TË NJËJTA / GOTË PREJ BAKRI | | | BELGJIKA / EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN | | THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI / “I” para dy “E” | | | | | MA JEP / ISH BOKSIERI LIKA (shq.) | | | |
| NAIM ISMAJLI | | | RRUGA E HAPUR NËN KODËR / MBATHËSET SPORTIVE | | | | | | | BIXHOZ / BASHKËT. | | | | | | BASHKËT. / FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN .... | |
| ZANORE | | KRITER / PATRIOTI PRISHTINA (shq.) | | | | | | SHKRIMTARI .... ZOLA / KËNGËTARJA .... KONÇI | | | | | KAFENE, RESTORANT / VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE | | | | SHTET NË AZI ...... LINDOR |
| EPOKA E RE | KRAHINË NË KOSOVË / NJËSI MATJEJE (sh.shq.) | | | | | OPEN MICROSCOPY ENVIRONMENT / KOMPOZITORI KOCI (shq.) | | | | MARKË E VESHJEVE SPORTIVE / PRIFT HEBRAIK | | | | | UGANDA, TANZANIA / KËNGËTARJA JONË ..... TAKE | | |
| LUMË NË SHQIPËRI | | | | HUQ, VES / NËNË | | | | | SHKRIMTARI HAZIRI (shq.) / AKTORJA E FAMSHME .... REID | | | | | | | | |
| LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI | | | | | LETRAT / ARTAN (perkdh.) | | | | | | | VËNIE E MINAVE / BASHKËT. | | | | | |
| NJERIU QË KA NDONJË GJYMTYRË ME CEN A TË PARALIZUAR | | | | | | | KOLEGJ UNIVERSITAR NË KOSOVË / ZANORE | | | | ISH DIZENJATORI ITALIAN VERSAÇI / MARC ANTHONY | | | | | ZANORE / ERMELINDA MEKSI | |
| ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER | | | | | | | | FUTBOLLISTI ANGLEZ FERDINAND / BASHKËT. | | | | KALORËS MESJETAR / PRAGA | | | | | |
| KOLOSI | | | | | | | NDENJËSE E GJATË KU MUND TË RRINË KATËR-PESË VETA | | | | | | | LLOJ VETURE FRANCEZE | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë*
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije*
*Ministri of Education, Science end Technology*

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë* bën:

**Shpallje të konkursit për *"Marrëveshje për shërbime të veçanta"***

**Institucioni:** *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë*

**Divizioni:** **Komunikim publik**
**Paga bruto:** **362.50 €**

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e administrativ (1 vend pune)**

**Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj**

**Vendi i punës: Prishtinë**
**Datë: 29.05.2018**

*Detyrat dhe përgjegjësitë:*

1. Përgatitja e raporteve të punës së divizionit për komunikim publik.
2. Përgatitja e dosjeve për faturat e marketingut të MASHT.
3. Punë tjera administrative të divizionit.

*Kualifikimet*

1. Kërkohet diploma e shkollës së mesme.
2. Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze.
3. Shkathtësi të larta në përdorimin e kompjuterit dhe programeve të avancuara kompjuterike.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 6 ditë kalendarike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 04.06.2018.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në uebfaqen e MASHT-it http://masht.rks-gov.net/, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, adresa: Rr. "Agim Ramadani" p.n. në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuara.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije vrši*:

**Objavljivanje konkursa za*"Sporazum o posebnim uslugama "***

**Institucija** *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

**Divizion:** **Komunikacije sa javnošću**
**Plata bruto:** **362.50 €**

**Naziv radnog mesta: Administrativni službenik/ca**
**(1 radno mesto)**

**Vreme trajanje ugovora: 6 meseci**

**Radno mesto: Priština Datum: 29.05.2018**

***Radni zadaci i odgovornost:***

1. Pripremnje radnih izveštaja divizije za komunikacji sa javnošću
2. Priprema dosije za fakture marketinga
3. Oslai administrativni poslovi divizije

*Kvalifikacije*

1. Zahteva se diploma srednje škole
2. Odlično poznavanje engleskog jezika
3. Visoke veštine u upotrebi kompjutera i svremene kompjuterske programe

**Uslovi učešće na konkurs:**

Pravo na podnošenje aplikacije imaju svi punoletni građeni građani Republike Kosova koji imaju sposobnost delovanja, da imaju potrebnu školsku spremu i profesionalnu sposobnost za izvršavanje obaveze i ona lica koja imaju fizičku sposobnost koja se zahteva za relevantan položaj.

**Datum završetka konkursa:** Konkurs je otvoren 6 kalendarska dana od dana objavljivanje na web stranici MONTE-a i dnevnoj štampi. Dan završetka konkursa je 04.06.2018.

Kandidati aplikacija ( obrazac za konkurisanje ) mogu preuzeti na web stranici MONT-a http://masht.rks-gov.net/, ili u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, kancelariji arhive u kojoj će kasnije popunjene aplikacije predati.

**Uz aplikaciju mora biti priložena:** Kopija lične karte, kopija dokumentacije o kvalifikovanju, kao i ostala dokumentacije potrebna shodno konkursu.

Zahtevi dostavljeni nakon isteka konkursa neće biti primljeni. Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na užoj listi biće kontaktirani

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Dardan Dragaj shpall të pavlefshme deftesat dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale Qendra e Kompetencës, Skenderaj.

▶ Smail Shatri shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curi" Romaje.

▶ Ferkan Mazrek shpall te pavlefshme deftesen e kl X shm "Ataturk Klisesi" Mamusha

▶ Arbenita Asllani shpall të pavlefshme deftesat e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likofc, Skenderaj.

▶ Frrok Nokaj shpall te pa vlefshme deftesat e viteve X,XI,XII dhe diplomen e Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

▶ Edonis Asllani shpall te pa vlefshme diplomen e Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

▶ Naim Beqiri shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
28 -05- 2018
Nr. 4146
PRISHTINË-A

KEK

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

## Njoftim për Anulimin e Konkursit

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. njofton te gjithë kandidatët te cilët kane aplikuar për pozitat: Zyrtar i Auditimit te Brendshëm, për anulimin e Konkursit te shpallur me dt. 04.04. 2018, me Nr.2623, e publikuar në shtypin ditore 5.04.2018.

Anulimi i konkursit për pozitat e lartcekura behet sipas Vendimit te Komisionit te Auditimit te KEK Sh.A, te dt. 25.05.2018, Nr. 4126.

Kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit në konkurs.

*Prishtinë: 28.05.2018*

per KEK

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
28 -05- 2018
Nr. 4146
PRISHTINË-A

KEK

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

## Obaveštenje o Otkazivanju Konkursa

Energetska Korporacija Kosova D.D. obaveštava sve kandidate koji su konkurisali za poziciju: Službenika za Unutrašnju Reviziju, o otkazivanju konkursa koji je objavljen dt. 04.04.2018, sa br. 2623, i objavljen u dnevnim novinama dt. 05.04.2018.

Otkazivanje konskursa za gore pomenutu poziciju vrši se u skladu sa Odlukom Upravnog Odbora KEK-a d.d., dt.25.05.2018, br. 4126.

Molimo učesnike konkursa za razumevanje.

*Priština: 28.05.2018*

Za KEK d.d.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 3, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, pastaj nenin 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, nr. 14/2014 dhe të nenit 4, paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr. 23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, Komuna e Klinës në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për kategoritë të dala nga lufta e UÇK-së, me ndihmën e Programit të veçantë të banimit, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, jep banesa me qira joprofitabile për periudhën kohore të caktuar sipas marrëveshjes dhe bën shpalljen publike të:

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
Nr.No.Br. 06 360-3782
Data-Date-Datum 29.05.20
Klinë-Klina

**KONKURSIT**

Komuna e Klinës ka siguruar program të veçantë të banimit për familjet e kategorive të dalura nga lufta e UÇK-së, që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, duke ndarë banesa me qira joprofitabile për të krijuar kushte të përshtatshme për banim normal.

□ Kanë të drejtë të jenë përfitues të këtij programi vetëm familjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së që:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
4. Familje që jetojnë në objekte të huaja me ose pa qira.

□ **Përcaktimi i familjeve përfituese bëhet mbi bazën e kritereve të përparësisë si vijon më poshtë:**

a. Statusi i banimit;
b. Lartësia e të ardhurave;
c. Gjendja shëndetësore;
d. Invaliditeti i pjesëtarëve të familjes dhe
e. Përbërja/struktura familjare.

□ Kriteret shtese sipas strukturës së familjes të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2 i UA të MMPH-së nr.21/2010 janë si vijon:

- Familja e dëshmorit, invalid dhe veteran i luftës së UÇK-së;
- Familja e kryesuar nga një prind/prindi vetushqyes dhe
- Familja që ka në mbikëqyrje/përkujdesje fëmijët jetimë.

□ Aplikuesit që bëjnë kërkesë për të përfituar nga ky program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të komunës së Klinës se paku 5 (pesë) vite para kohës se aplikimit.

□ Për zgjedhjen e përfituesve nga Programi i veçantë i banimit përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të *Udhëzimit administrativ nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.*

□ Në rast se aplikuesit pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me më shumë anëtarë" (*sipas nenit 5, paragrafi 4, të Udhëzimit administrativ nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit).*

□ Komuna ka në dispozicion për këtë program të veçantë të banimit objektin banesor të ndërtuar në Klinë në rrugën "Agron Palucaj" pn, me 35 (*tridhjetë e pesë) njësi/banesa* të cilat i jep me qira joprofitabile për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

□ Organi komunal kompetent bën shpërndarjen e aplikacioneve pa pagesë, *në formë standarde*, për të gjithë aplikuesit e interesuar, ndërkaq të gjithë aplikuesit të njëjtat mund t`i marrin në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit të Komunës së Klinës, rruga "Abedin Rexha" pn, kati I, çdo ditë pune prej orës 8:30 deri në orën 15:00.

□ Kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohen dhe pranohen në komunë çdo ditë pune.

□ Konkursi mbetet i hapur *30 (tridhjetë) ditë* nga dita e shpalljes publike në njërën nga gazetat e përditshme, duke filluar prej dt. **30.05.2018** deri me **dt.29.06.2018**, ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet Komisionit vlerësues brenda 5 (pesë) ditësh.

□ Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bën shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të të dhënave të tjera të nevojshme të aplikuesve brenda 30 (*tridhjetë) ditëve, ndërkaq brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasuese do të bëjë vlerësimin dhe verifikimin në terren të parashtruesit të kërkesës.*

□ Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.

□ Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t`u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.

□ Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.

□ Përjashtohen nga përfitimi nga ky program familjet që kanë përfituar ndihmë në forma të tjera të të njëjtit nivel ose me të lartë sesa mund te përfitohet nga programet e veçanta te banimit.

□ Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.

□ Përfituesve iu ndahet banesa në shfrytëzim në afat të pacaktuar, me vlerësim të gjendjes ekonomike për çdo vit sipas dispozitave te Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit

□ Pas shpalljes së listës, familjeve të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit vlerësues, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë me shkrim brenda *30a (tridhjetë) ditëve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - MMPH*, nga dita e pranimit të Vendimit.

□ Për informata shtesë ju lutemi telefononi në numrin e telefonit: 038-200-43706 / 038-200-43732

Komuna e Klinës
Drejtori
Lorenc Marleku

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria-Vlada-Government***

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY
Agjencia e Metrologjisë / Metrology Agency / Agencija za Metrologiju

## F T E S Ë P U B L I K E

Njoftohen të gjitha palët e interesuara (Trupat për Vlerësimin e Konformitetit) se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia e Metrologjisë së Kosovës(AMK), mbështetur në nenin 13, paragrafi 2, 3 dhe 4, dhe nenin 35 të Ligjit nr.06/L-037 për Metrologji, nenin 5, të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2016 për Mënyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit, shpall **Ftesë Publike** për **emërimin** e trupave për vlerësimin e konformitetit për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore, të mbuluara me:

1. Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/22 për autorizimin e subjekteve për verifikim, shqyrtimin e konformitetit dhe matjeve zyrtare të mjeteve matëse të rrjedhjes së lëngjeve me përjashtim të ujit;
2. Udhëzimin Administrativ Nr.2009/20 për kushtet për autorizimin e personave juridik apo fizik për verifikimin e mjeteve matëse në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve;

Aktet e lartcekura (1 dhe 2) mund t'i gjeni në web-faqe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Kërkesa për emërim merret në Agjencinë e Metrologjisë, së bashku me faturën për aplikim në zyrët e AMK-së, ndërkaq dokumentacioni i plotësuar dorëzohet në Arkivin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Trupat për vlerësim të konformitetit për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore, bazuar në nenin 13, paragrafi 3 dhe nenit 35, paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-037 për Metrologji , duhet të jenë të akredituara.

Autorizimi-emërimi i Trupave për Vlerësimin e Konformitetit,vlenë për tri (3) vite, me mundësi të vazhdimit edhe për tri(3) vite tjera .

Operatorët e perzgjdhur duhet të jenë te akredituar dhe se implementimi i shërbimeve, duhet të bëhet brenda afatit 60 ditor, nga dita e autorizmit me qëllim që të verfikohet akreditimi nga MTI-ja

Ftesa Publike do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e aplikimit në mjetet e informimit.

Për çdo paqartësi, te gjithë operatorët ekonomikë që aplikojnë për emërim në kompetencën e fushës së lartcekur, mund të vijnë paraprakisht të konsultohen në Agjencinë e Metrologjisë për këshilla rreth kompletimit të dosjes para se lënda të dorëzohet në arkiv të MTI-së.

Adresa:
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Agjencia e Metrologjisë së Kosovës
Nr. tel i zyrës: 038 512 121/ 038 512 798

Adresa Lagjja Spitali Rr.Muharrem Fejza pn 10.000 Prishtinë-Kosovë Tel:038 512 121, 038 512 798
http://www.ks-gov.net/mti-ks.org

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
**Ministria e Shëndetësisë**
**Ministarstvo Zdravstvoa - Ministry of Health**
*Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division*

## NJOFTIM PËR VAZHDIM TË KONKURSIT

Ne bazë te Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil te Kosovës si dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil dhe ne mbështetje te nenit 22 paragrafi 3 te kësaj rregulloreje vazhdon afati i konkursit edhe për 7 ditë, për konkursin e publikuar në gazetat ditore "Bota Sot" dhe "Epoka e Re" me datë 09 Maj 2018, si më poshtë:

1. MSh-14/05/18 - Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave;

Afati i vazhdimit te konkursit zgjatet edhe për shtatë (7) ditë, nga data 30/05/2018 deri me 05/06/2018.

## OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU KONKURSA

U skladu sa Zakonom br. 03 / L-149 o civilnoj službi Kosova i Pravilnikom br. 02/2010 o proceduri regrutacije u civilnoj službi , u skladu sa članom 22 stav 3 ovog pravilnika ,produžava se rok konkursa za još 7 dana za dolenavedeni konkurs objavljen u dnevnim novinama "Bota Sot" i "Epoka e Re" dana 09 maja 2018 godine:

1. MZ-14/05/18 - Zvaničnik za informisanje i monitoring medija.

Produženje konkursa važi za još sedam (7) dana, od 30.05.2018 do 05.06.2018.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria-Vlada-Government***

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY
Agjencia e Metrologjisë / Metrology Agency / Agencija za Metrologiju

## JAVNI POZIV

Obaveštavaju se sve interesovane strane (Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti) da Ministarstvo Trgovine i Industrije - Kosovska Agencija za Metrologiju (KAM), na osnovu člana 13, stav 2, 3 i 4 i člana 35 Zakona br. 06/L-037 o Metrologiji, člana 5, Administrativnog Uputstva br. 04/2016 o Načinu Ovlašćenja Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti, objavljuje **Javni Poziv** za **imenovanje** tela za ocenjivanje usaglašenosti za primenjena područja zakonske metrologije, pokrivena sa:

1. Administrativno Uputstvo Br. 2009/22 o ovlašćenju subjekata za verifikaciju, razmatranje usaglašenosti i službenih merenja sa sredstvima merenja protoka tećnosti izuzev vode;
2. Administrativno Uputstvo Br.2009/20 o uslovima za ovlašćenja za pravna ili fizićka lica za verifikaciju sredstva za merenje u centrima tehnićke kontrole motornih vozila;

Navedeni akti (1 i 2) mogu se naći na veb stranici Ministarstva Trgovine i Industrije.

Zahtev za imenovanje se uzima u Agenciji za Metrologiju zajedno sa faturom za apliciranje u kancelarije KAM-a, dok se popunjena dokumentacija dostavlja Arhivu Ministarstva Trgovine i Industrije.

Na osnovu člana 13, stav 3 i člana 35, stav 2 Zakona br. 06/L-037 o Metrologiji, tela za ocenjivanje usaglašenosti za primenjena područja zakonske metrologije, trebaju biti akreditovani.

Ovlašćenje - imenovanje Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti važi tri (3) godine, uz mogućnost produženja za još tri (3) godine.

Odabrani operateri treba da budu akreditovani i da se sprovođenje usluga treba obaviti u roku od 60 dana od dana ovlašćenja sa ciljem verifikacije akreditacije od strane MTI-a.

Javni Poziv će biti otvoren 15 kalendarskih dana od dana apliciranja u sredstvima informisanja.

Za bilo kakvu nejasnoću, svi ekonomski operateri koji apliciraju za imenovanje u nadležnosti pomenutog područja mogu se javiti unapred da se konsultuju u Agenciji za Metrologiju za savete o kompletiranju dosijea pre nego što se predmet dostavi u arhivu MTI-a.

Adresa:
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Kosovska Agencija za Metrologiju
Br. tel kancelarije: 038 512 121/ 038 512 798

Adresa Lagjja Spitali Rr.Muharrem Fejza pn 10.000 Prishtinë-Kosovë Tel:038 512 121, 038 512 798
http://www.ks-gov.net/mti-ks.org




ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333